



# **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

**për krijimin e marrëdhënies parapaguese dhe  
shfrytëzimin e shërbimeve të  
Makedonski Telekomit - Shkup**

# Kushtet e përgjithshme për krijimin e marrëdhënies parapaguese dhe shfrytëzimin e shërbimeve të Makedonski Telekomit - Shkup

HYRJE.....	5
DISPOZITAT KRYESORE.....	5
1.1. Lëndë e Kushteteve të përgjithshme .....	5
1.2. Lëndë e Marrëveshjes për krijimin e marrëdhënies parapaguese .....	5
1.3. Sigurimi i shërbimeve elektronike komunikuese publike .....	5
RËNDËSIA E SHPREHJEVE TË PËRMBAJTURA NË KUSHTET E PËRGJITHSHME .....	6
PALËT KONTRAKTUESE TË KONTRATËS PËR KRIJIMIN E MARRËDHËNIES PARAPAGUESE .....	7
3.1. Emri dhe adresa e Makedonski Telekomit .....	7
3.2. Parapaguesi .....	7
3.2.1. Personi fizik .....	7
3.2.2. Personi juridik.....	7
3.2.3. Personi juridik me status të veçantë.....	7
MODELET TARIFORE DHE SHËRBIMET SHITESË.....	7
4.1. Modelet tarifore .....	7
4.2. Shërbime shtesë, shërbime me vlerë të shtuar dhe shërbime të tjera .....	8
CILËSIA E NEVOJSHME E SHËRBIMEVE.....	8
5.1. Obligimet për cilësinë e shërbimeve publike të komunikimit .....	8
ÇMIME DHE PAGESA .....	8
6.1. Çmime dhe pagesa .....	8
6.2. Kompensimi për kyçjen fillestare.....	9
6.3. Fatura e detajuar .....	9
6.4. Parapagesa .....	9
6.5. Kompensim për kyçje për parapaguesin për kohësisht të shkyçur për shkak të mospagesës .....	9
6.6. Pagesa .....	10
6.7. Mënyra e pagesës .....	10
6.8. Pagesë me avancë dhe depozit .....	10
6.9. Afati i pagesës së faturës .....	10
6.10. Përllogaritja e kamatvonesës për pagesën jo në kohë.....	10
6.11. Zbritje.....	11
6.12. Kthimi i të hollave.....	11

6.13. Mënyra e kthimit të mjeteve financiare .....	11
Kapitulli VII .....	11
KRIJIMI I NJË MARRËDHËNIE PARAPAGUESE .....	11
7.1. Baza për krijimin e marrëdhënies parapaguese .....	11
7.2. Rregulla formale dhe procedurale për kontraktimin e marrëveshjes për marrëdhënien parapaguese ...	12
(A) Përgatitja e kërkesës .....	12
(B) Të dhëna të domosdoshme të kërkesës dhe dokumente të nevojshme .....	12
(C) Kërkesa prioritare.....	14
(Ç) Refuzimi/pezullimi i kërkesës .....	14
7.3. Kontraktimi i marrëveshjes për marrëdhënien parapaguese.....	14
7.4. Kycja/Lidhja .....	15
7.5. Shërbime komunikuese.....	16
7.6. Pajisja terminale parapaguese dhe instalimet.....	16
7.7. Ndryshime të Kontratës.....	16
KUFIZIMI OSE NDËRPRERJA E QASJES NË SHËRBIMET E KOMUNIKIMEVE PUBLIKE .....	16
8.1. Kufizimi ose ndërprerja e shërbimeve komunikuese.....	16
8.2. Procedura për ndërprerjen e sigurimit të shërbimeve komunikuese për shkak të mospagesës.....	17
8.2.1. Procedura për ndërprerjen e shërbimeve fikse të komunikimit elektronik .....	17
8.2.2. Procedura për ndërprerjen e shërbimeve celulare të komunikimit elektronik.....	17
8.3. Pagesa e kërkesave në mënyrë gjyqësore .....	18
8.4. Ndërprerje e përkohshme në sigurimin e shërbimeve të komunikimit (Pezullim) .....	18
8.5. Shkycja e shërbimeve të komunikimit gjatë falimentimit dhe likuidimit.....	18
8.6. SIM kartelë e humbur ose e vjedhur .....	18
SHËRBIME TË TJERA .....	18
9.1. Zhvendosja e linjës parapaguese me kërkesë të parapaguesit .....	18
9.2. Ndryshimi i numrit parapagues.....	18
9.3. Ndryshimi i emrit të parapaguesit në adresë të njëjtë (personi fizik) .....	19
9.4. Ndryshimi i emrit të parapaguesit (personit juridik), ndarja e një personi juridik në një ose më shumë persona juridikë (pasardhësit juridikë) .....	19
9.5. Bartja e të drejtës së përdorimit të linjës parapaguese .....	19
9.6. Ndryshimi i të dhënave të parapaguesit .....	20
9.7. Ndryshime të shërbimeve .....	20
9.8 . Shërbime që do t'i sigurojnë operatorët/ ofruesit e tjerë të shërbimeve komunikuese .....	20
9.9. Kalimi i numrit ose ndryshimi i operatorit të rrjetit publik fiks ose celular të komunikimit elektronik. ...	20
9.9.1. Obligimet e Makedonski Telekomit, kur ai paraqitet si operator ofrues.....	20
9.9.2. Obligime të parapaguesit kur Makedonski Telekom paraqitet si operator ofrues .....	21
9.9.3. Obligime të Makedonski Telekomit, kur paraqitet si operator pranues .....	21
9.9.4. Obligime të parapaguesit, kur Makedonski Telekom paraqitet si operatues pranues .....	21
9.10. Bartja gjeografike e numrit .....	22

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE .....	22
10.1. Të drejtat e parapaguesit.....	22
10.2. Të drejtat e Makedonski Telekomit .....	23
10.3. Detyrimet e parapaguesit .....	24
10.4 Detyrimet e Makedonski Telekomit .....	24
KOHËZGJATJA DHE NDËRPRERJA E KONTRATËS, NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES JURIDIKE PARAPAGUESE.....	25
11.1. Kohëzgjatja e kontratës parapaguese .....	25
11.2. Ndërprerja e kontratës nga ana e parapaguesit .....	25
11.3. Ndërprerja e kontratës nga ana e Makedonski Telekomit.....	26
KUNDËRSHTIME .....	26
12.1. Parashtrimi i kundërshtimeve .....	26
Mbledhja, përpunimi, ruajtja dhe mbrojtja e të dhënave të abonuesve .....	27
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE .....	27
14.1. Ndryshimet dhe Plotësimet e Kushteve të përgjithshme .....	27
14.2. Zbatimi i Kushteve të përgjithshme.....	27
14.3. Forca madhore .....	27
14.4. Zgjidhja e kontesteve .....	27
14.5. Hyrja në fuqi.....	28

## HYRJE

Kushtet e përgjithshme për vendosjen e marrëdhënies parapaguese dhe për shfrytëzimin e shërbimeve të Makedonski Telekom SHA Shkup (në tekstin e mëtejshëm: Kushtet e përgjithshme) i përmbajnë dhe i rregullojnë kushtet e përgjithshme të Marrëveshjes standarde parapaguese për krijimin e marrëdhënieve parapaguese për sigurimin e qasjes në rrjetin publik të komunikimit dhe përdorimin e shërbimeve elektronike publike të komunikimit të Makedonski Telekom (në tekstin e mëtejshëm: Marrëveshja), duke i përfshirë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.

Këto Kushte të përgjithshme janë në përputhje me Ligjin për Komunikime Elektronike, Rregulloren për llojin dhe përmbajtjen e të dhënave dhe informacioneve për kushtet e përgjithshme lidhur me qasjen dhe përdorimin e shërbimeve publike të komunikimit të publikuara nga operatorët dhe për llojin dhe përmbajtjen e të dhënave që do t'i publikojë Agjencia e Komunikimeve Elektronike (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja), si dhe me rregullat dhe rregulloret e tjera relevante.

Makedonski Telekom SHA Shkup (në tekstin e mëtejshëm: Makedonski Telekom) mundet, veçanërisht nëse kërkohet nga kushtet e tregut ose rregulloret ligjore, t'i ndryshojë dhe/ose plotësojë këto Kushte të përgjithshme.

Këto Kushte të përgjithshme dhe ndryshimet e tyre janë të disponueshme për shqyrtim në çdo pikë të shitjes së Makedonski Telekom, si dhe në faqen e internetit [www.telekom.mk](http://www.telekom.mk).

Pjesë përbërëse e këtyre Kushteve të përgjithshme konsiderohen të dhënat elektronike nga regjistrat e Makedonski Telekom për aktivizimin dhe deaktivizimin e disa shërbimeve bazë dhe shtesë të komunikimit, si dhe shënimet për aktivizim dhe çaktivizim duke telefonuar në numrin e telefonit pa pagesë 122 të Kontakt qendrës së Makedonski Telekom.

Këto Kushte të përgjithshme do të zbatohen nga dita e publikimit të tyre në faqen e internetit [www.telekom.mk](http://www.telekom.mk) dhe do të zbatohen për të gjithë parapaguesit që janë abonues final të shërbimeve publike të komunikimit elektronik të Makedonski Telekom pas kësaj date.

Në bazë të kushteve dhe kritereve të njohura paraprakisht, parapaguesi mund të lidhë edhe marrëveshje komerciale shtesë për shfrytëzimin e shërbimeve të Makedonski Telekomit, me të cilat mund të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet që janë të ndryshme nga ato të përcaktuara në Kushtet e përgjithshme në fuqi.

## DISPOZITAT KRYESORE

### 1.1. Lëndë e Kushteteve të përgjithshme

Këto Kushte të përgjithshme, ndër të tjera, më në detaje i rregullojnë kushtet e përfshira në Marrëveshjen standarde të parapaguesve, të lidhur ndërmjet Makedonski Telekomit, si operator i rrjetit publik të komunikimit, nga njëra anë, dhe parapaguesve, si abonues final të shërbimeve publike të komunikimit elektronik, nga ana tjetër.

Në kuptim të këtyre Kushteve të përgjithshme, shërbimet e Telekomit të Maqedonisë përfshijnë: kycjen në rrjetin publik të komunikimit elektronik, qasjen në rrjetin publik të komunikimit elektronik, shërbimet publike të komunikimit elektronik, shërbimet me vlerë të shtuar, si dhe shërbime shtesë që mundësohen në bazë të këtyre Kushteve të përgjithshme dhe Marrëveshjes. Këto Kushte të përgjithshme nuk vlejnë për shërbimin e transmetimit të zërit përmes kabinave telefonike të Makedonski Telekom, shërbimet e ofruara nga një operator tjetër, si dhe shërbimet e tjera që në mënyrë decide janë të përjashtuara në tekstin e mëposhtëm.

### 1.2. Lëndë e Marrëveshjes për krijimin e marrëdhënies parapaguese

Baza për vendosjen e marrëdhënieve parapaguese për shfrytëzimin e shërbimeve të Makedonski Telekomit është marrëveshja e lidhur ndërmjet Makedonski Telekomit dhe abonuesit të shërbimeve. Marrëveshja ndërmjet Makedonski Telekom dhe abonuesit i rregullon edhe kushtet e veçanta me pëlqimin e të dyja palëve.

### 1.3. Sigurimi i shërbimeve elektronike komunikuese publike

Makedonski Telekom ofron shërbime të komunikimit elektronik në përputhje me Ligjin për komunikime elektronike (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe aktet nënligjore. Shërbimet publike të komunikimit elektronik janë të disponueshme për çdo abonues në kushte jodiskriminuese, objektive dhe transparente, përveç në rastet e kufizimeve në lidhje me kapacitetin e Makedonski Telekomit.

Makedonski Telekom nuk do të refuzojë ta plotësojë kërkesën e arsyeshme për shërbim të komunikimit elektronik nga cilido person i cili është i gatshëm t'i pranojë dhe respektojë kushtet e përdorimit të shërbimeve të Makedonski Telekomit.

Makedonski Telekom siguron lidhje dhe/ose qasje në rrjetin publik të komunikimit elektronik dhe/ose në shërbime publike të komunikimit elektronik për abonentët e tij – abonuesit final në përputhje me listën e shërbimeve të publikuara publikisht, të përfshira në Çmimoren zyrtare të Makedonski Telekom, bazuar në kontratën e lidhur, dhe pas kërkesës së pranuar paraprakisht për lidhjen e kontratës për parapagim, përveç në rastet e kufizimeve lidhur me kapacitetin dhe mundësitë teknike të Makedonski Telekom, për të cilat shtruesi i kërkesës njoftohet me shkrim.

## RËNDËSIA E SHPREHJEVE TË PËRMBAJtura NË KUSHTET E PËRGJITHSHME

Secila nga shprehjet e mëposhtme e ka rëndësinë vijuese:

1. Rrjeti i komunikimit elektronik është një sistem transmetimi edhe aty ku është e aplikueshme, pajisja komutuese dhe mjete të tjera, duke përfshirë edhe elementë të rrjetit që nuk janë aktiv, ndërsa të cilët mundësojnë transmetimin e sinjaleve me tel, radio-valë, në mënyrë optike ose mjete të tjera elektromagnetike, duke i përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet tokësore fikse (me komutim qarkor ose me komutim të paketave, duke përfshirë internetin) dhe rrjetet mobile të lëvizshme, sistemet kablore elektroenergjetike, nëse përdoren për transmetimin e sinjaleve të komunikimit, rrjetet e transmetimit dhe rrjetet televizive kablore, pavarësisht nga lloji i informacionit të transmetuar;
2. Shërbimi i komunikimit elektronik është një shërbim që zakonisht ofrohet me pagesë, i cili përbëhet tërësisht ose kryesisht nga transmetimi i sinjaleve përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe përfshin shërbimet e telekomunikacionit dhe shërbimet e transmetimit në rrjetet e dedikuara për transmetimin ose ritransmetimin e përmbytjes së programit, por i përjashton shërbimet që mundësojnë ose ushtrojnë kontroll editorial mbi përmbytjet e transmetuara duke përdorur rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike, dhe nuk i përfshin as shërbimet e shoqërisë informatike që, tërësisht ose pjesërisht, nuk konsistojnë në transmetimin e sinjaleve nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike;
3. Posta elektronike është një mesazh në formë teksti, zëri ose imazhi të transmetuar përmes një rrjeti publik të komunikimit elektronik, që mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen terminale të marrësit, derisa marrësi nuke e merr atë;
4. Një rrjet publik i komunikimeve elektronike është një rrjet komunikimi elektronik që përdoret tërësisht ose pjesërisht për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike të disponueshme publikisht që mbështesin transferimin e informacionit ndërmjet pikave fundore të rrjetit;
5. Një shërbim publik i komunikimit elektronik është një shërbim komunikimi elektronik i disponueshëm për publikun;
6. Shërbimi telefonik i disponueshëm publikisht është një shërbim i disponueshëm për publikun për kryerjen dhe marrjen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të thirrjeve nacionale ose nacionale dhe ndërkombëtare nëpërmjet një numri ose numrash nga plani nacional ose ndërkombëtar i planit të numrave telefonik;
7. Identifikimi i abonuesit nënkupton një kod unik identifikimi që i caktohet një parapaguesi ose abonuesi të regjistruar për shërbimin për qasje në Internet ose për shërbim komunikimi përmes Internetit;
8. Një shërbim me vlerë të shtuar është një shërbim që kërkon përpunimin e të dhënave të trafikut ose të të dhënave të vendndodhjes, më shumë se sa është e nevojshme për të siguruar transmetimin e komunikimit ose arkëtimin e tij;
9. Një pikë përfundimi e rrjetit është një pikë fizike në të cilën parapaguesi ka akses në një rrjet komunikimi publik. Kur rrjetet përfshijnë ndërrimin ose orientimin, pika fundore e rrjetit identifikohet nga një adresë unike rrjeti, e cila i referohet një numri ose emri të parapaguesit;
10. Pajisja terminale është një produkt ose pjesë përkatëse e tij që mundëson komunikimin në një mënyrë që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me një pikë fundore rrjeti të një rrjeti publik të komunikimit elektronik që përdoret tërësisht ose pjesërisht për të ofruar shërbime publike të komunikimit elektronik;
11. Të dhënat për komunikacionin e komunikimit janë të dhëna që përpunohen me qëllim të transmetimit të komunikimit përmes një rrjeti publik të komunikimit elektronik ose për qëllime të arkëtimin të tij;
12. Të dhënat e lokacionit janë të dhëna të përpunuara në një rrjet publik komunikimi elektronik ose nga një shërbim publik i komunikimit elektronik që tregon vendndodhjen gjeografike të pajisjes terminale të abonuesit final të një shërbimi publik të komunikimit elektronik;
13. Shkelja e sigurisë së të dhënave personale është një shkelje që çon në shkatërrim aksidental ose të paligjshëm, humbje, ndryshim, zbulim të paautorizuar ose qasje në të dhënat personale që transmetohen, ruhen ose përpunohen ndryshe në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike të komunikimit elektronik;
14. Prezantimi i identifikimit të linjës së thirrjes është një shërbim që i mundëson abonuesit të thirrur ta identifikojë pikën përfundimtare të rrjetit nga e cila fillon thirrja bazuar në një numër ose kod të ndarë për atë pikë përfundimtare të rrjetit;
15. Prezentimi i identifikimit të linjës së thirrur është një shërbim që i mundëson abonuesit i cili bën thirrje ta identifikojë pikën përfundimtare të rrjetit ku përfundon thirrja në bazë të numrit ose kodit të caktuar për atë pikë përfundimtare të rrjetit;
16. Numri është numër i përcaktuar me Planin për numerim për rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimit të Republikës së Maqedonisë;
17. Numrat e shërbimit për thirrjet emergjente janë numra nga Plani i numerave për rrjetet dhe shërbimet publike të komunikimit të Republikës së Maqedonisë që janë të dedikuara posaçërisht për policinë, shërbimin zjarrfikës, ndihmën emergjente mjekësore, shërbimin për njoftim dhe alarm, duke përfshirë numrin e vetëm evropian për thirrjet e urgjencës "E-112", si dhe numrin e vetëm evropian 116.000, i cili është i dedikuar për raportimin e fëmijëve të zhdukur;
18. Parapaguesi është personi fizik ose juridik, i cili, për përdorimin e shërbimeve publike të komunikimit elektronik, lidh kontratë me një operator që i ofron këto shërbime;
19. Shfrytëzuesi është personi fizik ose juridik që përdor ose kërkon një shërbim publik të komunikimit elektronik, abonues është personi fizik që përdor një shërbim publik të komunikimit elektronik për qëllime private ose biznesi dhe që

nuk duhet patjetër të jetë i abonuar për ato shërbime;

20. Abonuesi final është një abonues që nuk ka një rrjet komunikimi publik ose nuk ofron një shërbim komunikimi publik.

### Kapitulli III

#### PALET KONTRAKTUESE TË KONTRATËS PËR KRIJIMIN E MARRËDHËNIES PARAPAGUESE

Palët e kontraktuara në Kontratë janë Makedonski Telekom, si operator i rrjetit elektronik të komunikimit, nga njëra anë dhe parapaguesit si abonues final i shërbimeve elektronike të komunikimit nga ana tjetër.

##### 3.1. Emri dhe adresa e Makedonski Telekomit

Emri i Kompanisë është Makedonski Telekom, Shoqëria Aksionare për Komunikime Elektronike, emri i shkurtuar i Kompanisë është Makedonski Telekom SHA - Shkup. Selia e Kompanisë është në Shkup, në rrugën: "Kej 13-të Nëntori nr. 6 (në tekstin e mëtejme: Makedonski Telekom).

##### 3.2. Parapaguesi

Parapaguesi i shërbimeve të Makedonski Telekom mund të jetë personi fizik ose juridik i cili për të siguruar qasje në rrjetin publik të komunikimit dhe për të përdorur shërbimet publike të komunikimit elektronik, lidh marrëveshje me Makedonski Telekom.

##### 3.2.1. Personi fizik

Person fizik në kuptimin e këtyre Kushteve të përgjithshme është personi që ka aftësi juridike dhe afariste dhe që ka lidhur një kontratë standarde abonimi për përdorimin e shërbimeve të komunikimit.

Personi fizik i huaj mund të jetë parapaguesi i shërbimeve të Makedonski Telekomit, nëse përveç dokumenteve të tjera të nevojshme të dhëna në pikën 7.2. (B), me kërkesë të Makedonski Telekomit, ka dorëzuar garanci financiare për përmbushjen e detyrimeve për pagesë nga kontrata.

##### 3.2.2. Personi juridik

Një person juridik është një subjekt i regjistruar në Regjistrin qendror të RM-së.

Personat fizikë të angazhuar në profesione të lira (avokatë, mjekë, noterë, kontabilistë dhe të tjerë), sipas këtyre Kushteve të përgjithshme, konsiderohen persona juridikë.

##### 3.2.3. Personi juridik me status të veçantë

Parapaguesi mund të jetë personi i huaj juridik, organizatë ndërkombëtare ose misioni nëse dorëzon dëshmi për regjistrimin e tij në organet kompetente shtetërore në Republikën e Maqedonisë. Dokumentet e nevojshme për personat juridikë jepen në pikën 7.2. (B).

##### 3.3. Qendra e kontaktit dhe pikat e shitjes së marrëdhënieve me klientët

Abonuesit, duke përdorur numrin e telefonit 122 në Kontakt Qendër, mund të marrin çdo informacion për llogaritë e tyre, borxhin, produktet dhe shërbimet, ofertat.

Shërbimi i raportimit të pengesave është i disponueshëm 6 ditë në javë, nga ora 7:00 deri në orën 20:00, në numrin e telefonit 122.

### Kapitulli IV

#### MODELET TARIFORE DHE SHËRBIMET SHITESË

##### 4.1. Modelet tarifore

Me lidhjen e marrëveshjes për parapagim, parapaguesi fiton të drejtën e përdorimit të shërbimeve të ofruara nga Makedonski Telekom në përputhje me modelin/pakon tarifore që e ka zgjedhur nga parapaguesi.

Parapaguesi mund të kërkojë ndryshimin e modelit tarifor, por më së shumti një herë në muaj, për të cilin paguan tarifë sipas Çmimoreve të Makedonski Telekomit.

Parapaguesi e zgjedh modelin e dëshiruar tarifor në mënyrë të pavarur dhe me vullnetin e tij të lirë, në përputhje me këto Kushte të përgjithshme dhe Çmimoret e vlefshme të Makedonski Telekomit.

Modelet tarifore të ofruara nga Makedonski Telekom janë në dispozicion të parapaguesve të personave fizikë dhe juridikë.

Karakteristikat e secilit model tarifor dhe kombinimet e mundshme ndërmjet opsioneve tarifore janë të përcaktuara në Çmimet e vlefshme të Makedonski Telekom.

## 4.2. Shërbime shtesë, shërbime me vlerë të shtuar dhe shërbime të tjera

Me kontraktimin e marrëveshjes kontraktuese, parapaguesi fiton të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve shtesë, shërbimeve me vlerë të shtuar dhe shërbime të tjera.

Aktivizimi dhe deaktivizimi i shërbimeve shtesë, shërbimeve me vlerë të shtuar dhe shërbimeve të tjera mund të bëhet nga parapaguesi në një nga mënyrat e mëposhtme, në varësi të llojit të shërbimit:

- me nënshkrimin e formularit përkatës (kërkesë, aneks ndaj marrëveshjes);
- duke thirrur në numrin përkatës të telefonit, të caktuar për këtë qëllim;
- në mënyrë elektronike përmes ueb faqes së Makedonski Telekomit;
- duke dërguar SMS mesazh në një numër përkatës telefoni për këtë qëllim; në mënyrë tjetër në dispozicion për parapaguesin (ueb faqja, ueb portale abonuese, aplikacione celulare dhe automat vizual).

Përdorimin e disa shërbimeve shtesë për të cilat nuk paguhet tarifë shtesë mujore dhe që janë automatikisht të disponueshme për parapaguesin duke e zgjedhur modelin tarifor që do ta përdorë, parapaguesi mund ta anulojë me kërkesën e tij.

Regjistrimet elektronike nga evidenca e Makedonski Telekomit për aktivizimin dhe deaktivizimin e shërbimeve të komunikimit elektronik me mjete elektronike (SMS, audio incizim, thirrje në numrin e telefonit, ueb faqe, e-mail, nënshkrim elektronik dhe të tjera), si dhe administrimin e të dhënave të tjera për parapaguesit konsiderohen si pjesë përbërëse e kontratës për parapagim dhe ato do të mbahen nga Makedonski Telekom deri në skadimin e vlefshmërisë së kontratës për parapagim.

Parapaguesi e merr përsipër të paguajë kompensim për shfrytëzimin e shërbimeve shtesë sipas Çmimores së Makedonski Telekomit. Kompensimi për përdorimin e shërbimeve shtesë faturohet në faturën e rregullt mujore për përdorimin e shërbimeve të komunikimit celular dhe fiks.

Abonenti merr përsipër të mbulojë të gjitha kostot për përdorimin e shërbimeve shtesë, të cilat ai i përdor në çdo bazë. Në rast të mospërbushjes së detyrimit për mbulimin e shpenzimeve, Makedonski Telekom ka të drejtë që përkohësisht të shkyçë linjën e parapaguesve, në përputhje me këto Kushte të përgjithshme.

Pas shtrimit të kërkesës për aktivizimin ose çaktivizimin e shërbimeve shtesë, Makedonski Telekom duhet të veprojë jo më vonë se 3 (tri) ditë pune nga data e shtrimit të kërkesës.

## Kapitulli V

### CILËSIA E NEVOJSHME E SHËRBIMEVE

#### 5.1. Obligimet për cilësinë e shërbimeve publike të komunikimit

Makedonski Telekom duhet ta sigurojë cilësinë e shërbimeve publike të komunikimit elektronik në nivelin e përcaktuar me Ligjin për komunikime elektronike dhe aktet e tjera nënligjore.

## Kapitulli VI

### ÇMIME DHE PAGESA

#### 6.1. Çmime dhe pagesa

Makedonski Telekom i përcakton çmimet për qasje dhe shfrytëzim të shërbimeve publike të komunikimit elektronik në Çmimoren zyrtare dhe në faqen e tij të internetit.

Abonuesi paguan kompensim të njëfishtë për kyçjen fillestare, kompensim mujor (abonim), si dhe kompensim për vëllimin e realizuar të trafikut të komunikimit dhe për shërbimet shtesë që i përdor.

Çmimet e shërbimeve publike të komunikimit elektronik i përcakton, i ndryshon dhe i plotëson Makedonski Telekom, në përputhje me rregulloret pozitive.

Makedonski Telekom ka të drejtë një herë në vit që çmimet e shërbimeve publike të komunikimit elektronik t'i përshtatë me indeksin vjetor të shpenzimeve të jetesës - COICOP (në tekstin e mëtejme: Indeksi vjetor) i publikuar nga organi i autorizuar shtetëror.

Në rast të rritjes ose zvogëlimit të Indeksit Vjetor për më shumë se 1%, Makedonski Telekom ka të drejtë t'i rrisë ose zvogëlojë çmimet e shërbimeve publike të komunikimit elektronik në lartësinë e ndryshimit të Indeksit Vjetor. Ndryshimet e Indeksit Vjetor më pak se dhe të barabartë me 1% nuk do të merren parasysh.

Ndryshimi në përqindje i çmimeve të shërbimeve publike të komunikimit elektronik të Operatorit nuk do të jetë më i madh se ndryshimi në përqindje në Indeksin Vjetor për vitin përkatës.

Një ndryshim i tillë do të bëhet në çmimet aktuale të shërbimeve brenda 3 (tre) muajve llogaritur nga dita e parë e muajit pas publikimit të Indeksit Vjetor nga një autoritet i autorizuar. Çmimi i shërbimeve publike të komunikimit elektronik në përputhje me Indeksin Vjetor do të jetë baza për harmonizimet e ardhshme.

Operatori ka të drejtë të fillojë aplikimin e mekanizmit për harmonizimin e çmimeve me Indeksin Vjetor që nga momenti i shpalljes së tij për vitin 2024.



Makedonski Telekom do t'i informojë abonentët për ndryshimin e çmimeve të shërbimeve të tij përmes ueb-faqes ose në një mënyrë tjetër lehtësisht të qasshme për abonuesit.

Rregullimi i çmimeve të shërbimeve në përputhje me Indeksën Vjetor nuk konsiderohet ndryshim i kushteve të kontratës së abonimit dhe abonuesi nuk ka të drejtë ta shkëpusë para kohe kontratën pa paguar penalitete ose penalitete kontraktuale.

Nëse ka ndryshim në çmimet e shërbimeve ose në mënyrën e tarifimit të tyre, Makedonski Telekom do t'i njoftojë parapaguesit me shkrim, në afat jo më të shkurtër se 30 ditë para ditës së vendosjes së ndryshimeve.

Makedonski Telekom mund të vendosë një sistem të pagesave paraprake për shfrytëzimin e shërbimeve të komunikimit përmes kuponëve me vlerë (sistem pripejd).

## 6.2. Kompensimi për kycjen fillestare

Parapaguesi paguan kompensim të njëfishtë për kycjen fillestare me një rrjet komunikimi publik.

Kompensim i njëfishtë paguhet gjatë zhvendosjes së kycjes në një adresë tjetër dhe për transferimin e të drejtës së parapagimit të një person tjetër.

## 6.3. Fatura e detajuar

Makedonski Telekom përgatit një faturë të detajuar për parapaguesit për të kontrolluar shumën e arkëtuar të shërbimeve, me çka i mundëson t'i kontrollojë shpenzimet për përdorimin e shërbimeve të komunikimit elektronik të përdorur pa të dhëna për thirrjet në numrat e telefonit pa pagesë dhe numrat e shërbimeve të thirrjeve emergjente si dhe një pasqyrë të detajuar të trafikut të realizuar me kërkesë të tyre për maksimum 6 muaj në të kaluarën, duke llogaritur nga dita e marrjes së kërkesës.

Fatura do të lëshohet në emër të parapaguesit dhe do të dërgohet në adresën e tij ose në adresën në të cilën vetë parapaguesi ka kërkuar të dorëzohet ose në një mënyrë tjetër që parapaguesi është pajtuar. PAGESA E FATURËS DO TË KONSIDEROHET SE ËSHTË BËRË NË DITËN E KRYERJES SË PAGESËS.

## 6.4. Parapagesa

Parapagesa është shumë mujore që i paguhet parapaguesit prej më parë për çdo muaj si kompensim për përdorimin e shërbimit të komunikimeve elektronike, pavarësisht nëse abonenti e përdor atë apo jo.

Me rastin e krijimit të marrëdhënies parapaguese, parapagimi bëhet duke filluar nga dita kur pajisja terminale e parapaguesit është kyçur në rrjetin komunikues të Makedonski Telekomit, përkatësisht nga dita e aktivizimit të shërbimit të kërkuar të komunikimit elektronik.

Makedonski Telekom në faturën e parë parapaguesit do t'i faturojë parapagimin për periudhën e kaluar fillestare të përdorimit të shërbimit të komunikimit, si dhe shumën e parapagimit për muajin aktual. Nëse marrëdhënia abonuese gjatë muajit kalendarik është më e shkurtër se 30 ditë, abonimi mujor dhe abonimi në bazë të shërbimeve shtesë tarifohen në atë mënyrë që 1/30 e abonimit mujor dhe abonimi në bazë të shërbimeve shtesë të llogariten për çdo ditë. (nëse e ka).

Parapagesa mujore faturohet deri në momentin kur Makedonski Telekom e ndërpret qasjen në shërbimet në të dyja drejtimet.

## 6.5. Kompensim për kycje për parapaguesin përkohësisht të shkyçur për shkak të mospagesës

**Për kycjen e sërishme të një parapaguesi të shkyçur, Makedonski Telekom e runa të drejtën që parapaguesit t'i paguaj shumë në pajtim me Çmimoren.**

Shërbimet me vlerë të shtuar tarifohen sipas ngjarje/thirrje dhe kohëzgjatjes.

Për shkak të harmonizimit me rregulloret e aplikuara në Bashkimin Evropian, Agjencia për Komunikime Elektronike parasheh në të ardhmen, kur të ketë mundësi teknike për të, përdorimin e një numri të vetëm për thirrjet emergjente 112. Agjencia për Komunikime Elektronike ka caktuar numra të tjerë, përveç 112, të cilët do të jenë të disponueshëm për thirrjet drejt llojeve të ndryshme të shërbimeve për raste urgjente:

- 192 - Policia
- 193 – Shërbimi zjarrfikës
- 194 – Ndihma e shpejtë
- 195 - Qendra për menaxhim me kriza

Agjencia e Komunikimeve elektronike ka dhënë numra të shkurtër për shërbime me rëndësi shoqërore:

- 196 – Shërbimi për ndihmë në rrugë
- 197 – Drejtoria doganore
- 198 – Drejtoria e të Ardhurave Publike
- 199 - Ministria e Punëve të Brendshme
- 190 Qendra e kontaktit e AKE

Thirrja drejt numrit të Shërbimit të Asistencës Rrugore tarifohet sipas tarifës së përcaktuar në Çmimoren e Makedonski Telekomit, ndërsa thirrjet ndaj numrave të tjerë janë pa pagesë.

## 6.6. Pagesa

Pagesa e shërbimeve të komunikimit elektronik të shfrytëzuara bëhet brenda afatit të shënuar në llogari (faturë).

Llogaritja dhe arkëtimi i shërbimeve në përputhje me këto Kushte të përgjithshme dhe kontratën fillon me aktivizimin e shërbimit të kërkuar.

Pagesa e faturave është përgjegjësi e parapaguesve. Mosmarrja e faturave nuk i liron parapaguesit nga detyrimi për të paguar shumën e përcaktuar në faturë brenda afatit të caktuar, gjegjësisht parapaguesi është i detyruar të kërkojë vetë një faturë nëse nuk e ka marrë. Parapaguesi mund të marrë kopje të llogarisë në pikat e shitjes së Makedonski Telekomit, për të cilën paguhet kompensim sipas Çmimores.

Pagesa do të konsiderohet se është bërë nga dita e kryerjes së pagesës. Informatat për shumën e faturave mund t'u jepen parapaguesve vetëm personalisht nga Qendra për Kontakt ose në ueb faqen e Makedonski Telekomit, me identifikimin nga llogaria, identifikimin e parapaguesit (PIN, PUK dhe kode të ngjashme).

Operatori do ta monitorojë sjelljen e zakonshme të parapaguesit gjatë përdorimit të shërbimeve të tij dhe do ta njoftojë atë pa pagesë, nëse konstaton ndonjë rritje të pazakontë dhe të papritur të shumës për përdorimin e shërbimeve të caktuara, që mund të tregojë keqpërdorim ose përdorim të paautorizuar. Një rritje e pazakontë dhe e papritur e shumës për përdorimin e shërbimeve të caktuara konsiderohet nëse shuma tejkalon të paktën dyfishin e shumës mesatare që parapaguesi e ka paguar në tre muajt e fundit për ato ekzistuese, pra dyfishi i shumës së parapagimit në muajin e fundit për parapaguesit e rinj. Makedonski Telekom ka të drejtë të kërkojë pagesë të parakohshme të shumës së pafaturuar. Nëse parapaguesi nuk e paguan shumën brenda afatit të caktuar, Makedonski Telekom e ruan të drejtën që përkohësisht ta pezullojë ofrimin e shërbimit.

## 6.7. Mënyra e pagesës

**Parapaguesit mund t'i paguajnë faturat në mënyra vijuese:**

- me para të gatshme dhe me kartela pagesore në vendet e shitjes së Makedonski Telekom SHA – Shkup si edhe në pajisjet për vetëpagesë;
- me para të gatshme në vendet e shitjes të agjentëve tanë të shitjes;
- në njësitet afariste të NP Posta e Maqedonisë ose në disa prej bankave afariste në Republikën e Maqedonisë;
- pagesë pa para të gatshme në dobi të xhiro llogarisë së vendosur në faturë;
- përmes urdhërësës pagesore nëse janë shfrytëzues të llogarive transaksionare në banka me të cilat Makedonski Telekom ka kontraktuar marrëveshje për pagesa të tilla;
- në mënyrë elektronike në ueb faqen e Makedonski Telekomit - <https://moj.telekom.mk> dhe <http://www.telekom.mk/plati-onlajn.nspj>, përmes aplikacionit celular TELEKOM MK

## 6.8. Pagesë me avancë dhe depozit

Parapaguesi ka të drejtë të depozitohet një shumë të caktuar të mjeteve si avancë pa interes në një xhiro-llogari, nga e cila do të tërhiqen mjete për shlyerjen e detyrimeve ndaj Makedonski Telekomit. Në këtë rast, arkëtimi i shërbimeve do të bëhet duke zbritur drejtpërdrejt nga mjetet e depozituara si avancë.

Makedonski Telekom ka të drejtë të kërkojë nga parapaguesi të depozitohet një shumë parash si depozitë dhe/ose garanci, dhe veçanërisht për qasje në rrjetin publik të komunikimit përkohësisht, kur lidh kontratë parapaguese me një parapagues që nuk është shtetas i Republikës së Maqedonisë ose me parapagues i cili nuk ka dëshmi adekuate për aftësinë paguese pas shkycjes së parapaguesit për shkak të vonesës ose pamundësisë për të paguar, si dhe në rast të komunikacionit të pazakontë.

Për këtë qëllim, këta persona, krahas nënshkrimit të marrëveshjes standarde të pajtimit, duhet të nënshkruajnë edhe një aneks/konfirmim të marrëveshjes së pajtimit për pagesën e depozitës. Shuma e depozitës do të publikohet në Çmimoren e Makedonski Telekomit (përveç rasti të komunikacionit të pazakontë), ndërsa pagesa e depozitës bëhet në dyqanet e Makedonski Telekomit.

Në rast të vonesës në pagesë, Makedonski Telekom ka të drejtë të përdorë depozitën për shlyerjen e obligimeve të parapaguesit. Nëse depozita nuk e mbulon të gjithë shumën e borxhit, Makedonski Telekom do ta informojë parapaguesin për shlyerjen e borxhit të mbetur.

Depozita do t'i kthehet parapaguesit, pa interes, pas skadimit të kontratës për shfrytëzimin e shërbimeve ose pas dhënies së dëshmisë adekuate për aftësinë pagesore të tij, me kusht që Makedonski Telekom të mos ketë pretendime financiare ndaj parapaguesit për çfarëdo arsye.

## 6.9. Afati i pagesës së faturës

Pagesa e shërbimeve, qofshin ato bazë apo shtesë, parapaguesi e bën në muaj brenda afatit të përcaktuar në faturë. Makedonski Telekom e ruan të drejtën të arkëtojë nga vlera e depozitës shumën që duhet të arkëtohet nga parapaguesi.

## 6.10. Përlllogaritja e kamatvonesës për pagesën jo në kohë

Në rast të pagesës së parakohshme të faturës, Makedonski Telekom për çdo ditë vonesë i llogarit kamatvonesë të parapaguesit, sipas normës së përcaktuar me ligj.

Kamatvonesa ligjore llogaritet për periudhën nga dita e parë pas skadimit të afatit të pagesës të përcaktuar në faturë deri në ditën e pagesës së faturës.

#### 6.11. Zbritje

Makedonski Telekom ofron shërbime me zbritje për kategori të caktuara të personave në përputhje me dispozitat e dhëna në Kushtet e përgjithshme për shërbimin universal.

Personi që kërkon t'i jepet zbritje është i detyruar si dëshmi ta paraqesë vendimin përkatës nga organi kompetent.

#### 6.12. Kthimi i të hollave

**Makedonski Telekom do t'ua kthejë të hollat parapaguesve në rastet vijuese:**

- nëse gjatë krijimit të marrëveshjes parapaguese, kërkuesi kryen pagesë të kompensimit për kyçjen fillestare, ndërsa më pas heq dorë nga qëllimi për krijimin e marrëdhënies parapaguese në periudhën e instalimit të kyçjes. Kthimi i mjeteve bëhet në tërësi;
- në rast të kufizimit të përkohshëm ose ndërprerjes së qasjes në shërbime, Makedonski Telekom rimbursion mjetet në pjesën e parapagesës dhe kompensimet për shfrytëzimin e shërbimeve shtesë (nëse parapaguesi i ka shlyer borxhet e tij) në shumën proporcionale me kohëzgjatjen kur shërbimi nuk është siguruar, nëse ndërprerja zgjat më shumë se 3 orë. Shuma e llogaritur, për të gjithë kohëzgjatjen e kufizimeve apo ndërprerjeve, do të zbritet nga fatura e radhës e të gjithë parapaguesve që kanë pasur kufizim apo ndërprerje, pa u kërkuar nga parapaguesit për një rrjet komunikimi fiks dhe pas një kërkesë të vlefshme nga parapaguesit për rrjet komunikimi celular. Në këtë rast, Makedonski Telekom nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë dëm të drejtpërdrejtë ose indirekt që mund t'i shkaktohet parapaguesit, lidhur me fitimin e humbur, mundësitë e humbura të tregtimit, reputacionin e humbur etj. ;
- në rastet e tjera të ankesës që ka bazë nga parapaguesi për një gabim të konstatuar në faturim që çon në rritje të shumës për shërbimet e komunikimit të përdorura, nëse ai ka shlyer borxhet, në masën e detyrimit të gabuar;
- në rast të ndërprerjes së ofrimit të shërbimit të komunikimit publik pa fajin e parapaguesit, Makedonski Telekom do të kthejë pjesën e mbetur të parave të depozituara si avancë, abonimin mujor, tarifën për shfrytëzimin e shërbimeve shtesë, nëse parapaguesi e kërkon, pas shlyerjes paraprake të borxhit total të parapaguesit.

#### 6.13. Mënyra e kthimit të mjeteve financiare

Në rastin siç është dhënë në pikën 6.12. Makedonski Telekom do të bëjë kthimin e mjeteve për parapaguesit edhe atë për:

##### 1) Persona fizikë

- Përmes qarkullimit pagesor me instrument pagesor në dobi të llogarisë transaksionare të personit fizik – parapagues të hapur në një bankë komerciale përkatëse në RM;
- Paga me para të gatshme.

##### 2) Persona juridikë

- Nëpërmjet qarkullimit pagesor me instrument pagesor në dobi të llogarisë së transaksionit të personit juridik-parapagues të hapur në një bankë komerciale përkatëse në RM.

Në rast siç është dhënë në pikën 6.12., alinea 2, 3, dhe 4, Makedonski Telekom do ta bëjë kthimin e mjeteve përmes zbritjes së shumës nga fatura e ardhshme e telefonit.

## Kapitulli VII

### KRIJIMI I NJË MARRËDHËNIE PARAPAGUESE

#### 7.1. Baza për krijimin e marrëdhënies parapaguese

Baza për vendosjen e marrëdhënies parapaguese për shfrytëzimin e shërbimeve të Makedonski Telekomit është marrëveshja në formë të shkruar për sigurimin e qasjes në rrjetin publik të komunikimit dhe për shfrytëzimin e shërbimeve publike të komunikimit të Makedonski Telekomit, e lidhur midis Makedonski Telekomit dhe abonuesit të shërbimeve.

Kontrata e kontraktuar me parapaguesin përmban:

- emri dhe adresa e operatorit;
- shërbimet që do të sigurohen, duke përfshirë veçanërisht:
  - informacione për atë nëse sigurohet shërbimi për qasje në shërbimet për thirrje urgjente dhe informacione për lokacionin e personit i cili e kryen thirrjen, si edhe të gjitha kufizimet për sigurimin e shërbimit për qasje deri tek shërbimet për thirrje urgjente;
  - informacione për të gjitha kushtet e tjera të cilat e kufizojnë qasjen dhe/apo shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikacioneve, informacione për nivel minimal të cilësisë së shërbimit që sigurohet, veçanërisht afati për kyçjen fillestare dhe kur është e përshtatshme, parametra të tjerë për cilësinë e shërbimit;
  - informacione për cila do procedura të përcaktuara nga operatori për matjen dhe formësimin e komunikacionit me qëllim që të shmanget stërngarkimi i lidhjes së rrjetit, si edhe informacione për atë se si do të ndikoni këto procedura në cilësinë e shërbimit,
- llojet e shërbimeve për mirëmbajtje dhe shërbime të parapara për mbështetjen e abonuesve, si edhe mënyrat për vendosjen e kontaktit me këto shërbime dhe

#### Kushte të përgjithshme

- të gjitha kufizimet e imponuara nga operatori lidhur me përdorimin e pajisjes terminale;
- mundësi që parapaguesit të prononcohen për futjen e të dhënave të tyre personale dhe cilat prej tyre do të kyçen në numrorët telefonikë dhe shërbimet telefonike për informacione;
- informacione për çmimet dhe tarifatat, mënyrën e marrjes së informacioneve më të reja për të gjitha tarifatat në fuqi dhe kompensimet për ruajtjen si edhe mënyrat e mundshme të pagesës, përfshirë edhe për të gjitha dallimet në shpenzimet që dalin nga mënyrat e mundshme të pagesës;
- kohëzgjatja e marrëveshjes dhe kushtet për rinovimin dhe ndërprerjen e shërbimeve dhe marrëveshjes, përfshirë:
- afati minimal i shfrytëzimit të shërbimeve nën kushtet promovuese të përcaktuara me oferta të veçanta,
- të gjitha taksat lidhur me transferimin e të dhënave dhe identifikatorë të tjerë dhe
- të gjitha taksat të cilat dalin nga shkëputja e marrëveshjes, përfshirë edhe kthimin e shpenzimeve lidhur me pajisjen terminale;
- të gjitha mënyrat e kompensimit dhe kthimit të mjeteve në rast të mospërbushjes së nivelit të dakorduar të cilësisë së shërbimit të siguruar;
- procedurën për zgjidhjen e ankesës;
- të gjitha llojet e aktiviteteve të cilat mund t'i ndërmerret operatori me qëllim që ta ruajë sigurinë e tij ose integritetin si përgjigje ndaj incidenteve, kanosjeve dhe shkeljeve;
- mënyrën e informimit të parapaguesve për ndryshimet e planifikuara në kushtet dhe mënyrën e pranimit të të rejave - kushtet për vazhdimin apo shkëputjen e marrëveshjes;
- procedura në rast të mospagesës ose pagesës jo në kohë të kompensimit për shërbimet;
- informacione veçanërisht të dedikuara për personat me aftësi ndryshe.

## 7.2. Rregulla formale dhe procedurale për kontraktimin e marrëveshjes për marrëdhënien parapaguese

### (A) Përgatitja e kërkesës

Personi i cili dëshiron të krijojë marrëdhënie parapaguese me Makedonski Telekom për ofrimin e një lloji të caktuar të shërbimeve publike të komunikimit parashtron kërkesë për themelimin e marrëdhënies parapaguese, personalisht ose përmes personit të autorizuar për atë qëllim me autorizim të nostrifikuar. Kërkesa për lidhjen e kontratës përgatitet në formë të paraparë dhe dorëzohet në Makedonski Telekom. Me shtrimin e kërkesës konsiderohet se aplikanti i pranon kushtet për shfrytëzimin e shërbimeve të Makedonski Telekom të përcaktuara me këto Kushte të përgjithshme dhe me Marrëveshjen.

Kërkesa, së bashku me këto Kushte të përgjithshme, janë pjesë përbërëse e Marrëveshjes.

Kërkesa duhet të përmbajë të gjitha të dhënat e kërkuara. Nëse kërkesa nuk përmban të dhënat e duhura, përfaqësuesi i Makedonski Telekomit e fton personin që e ka parashtruar kërkesën t'i shtojë të dhënat e nevojshme. Kërkesa konsiderohet se është shtruar nga Makedonski Telekom nga dita e plotësimit të rregullt, e kompletuar me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe nënshkrimin nga shtruesi i kërkesës.

Kërkesa për të krijuar një marrëdhënie parapaguese konsiderohet njëkohësisht si një kërkesë për instalimin e një linje parapaguese, gjegjësisht për të aktivizuar një shërbim të caktuar komunikimi dhe për të lidhur pajisjen terminale të abonuesit.

Gjatë shtrimit dhe shqyrtimit të kërkesës, Makedonski Telekom ka të drejtë të kërkojë nga aplikuesi që t'i dorëzojë dokumentet e kërkuara të përshkruara në kërkesë, dhe aplikanti është i obliguar që t'i dorëzojë dhe/ose t'i japë dokumentet e nevojshme Makedonski Telekomit për kontroll. Kërkesa duhet të nënshkruhet personalisht nga aplikanti ose nëpërmjet një personi të autorizuar me autorizim të nostrifikuar.

Kërkesa do të konsiderohet e pranuar me ditën e aktivizimit të shërbimit të kërkuar për komunikim.

### (B) Të dhëna të domosdoshme të kërkesës dhe dokumente të nevojshme

(a) Parapaguesi ekzistues të Makedonski Telekomit, të cilët paraprakisht i kanë shlyer rregullisht detyrimet e tyre financiare ndaj Makedonski Telekomit për shërbimet e shfrytëzuara të komunikimit, dhe të cilët në momentin e shtrimit të kërkesës nuk kanë borxh të papaguar ndaj Makedonski Telekom, gjatë shtrimit të kërkesës për shfrytëzimin e një shërbimi të ri komunikimi, i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

#### 1) Personi fizik

- dokument për identifikim personal në shqyrtim.

#### 2) Personi juridik

- Certifikatë për gjendjen vijuese të subjektit juridik të dhënë nga Regjistri qendror i RMV-së, jo më e vjetër se 90 ditë;

(b) Parapaguesit e rinj të Makedonski Telekomit, gjatë shtrimit të kërkesës për përdorimin e shërbimit të ri komunikues, i shtrojnë dokumentet vijuese.

#### 1) Personi fizik

- Dokument për identifikim për shqyrtim;
- Kontrolli i aftësisë pagesore të parapaguesit në Byronë Kreditore të Maqedonisë pa pëlqimit të dhënë ose Vërtetim për punësim jo më i vjetër se 30 ditë gjegjësisht çekun pensional (të barabartë ose mbi 5.000 den) jo më të vjetër se 3 muaj.

#### a) person fizik i papunë:

- Një dokument valid për identifikim (letërnjoftim apo pasaportë); dhe
- Pagesa e të hollave si garanci për pagesën e rregullt të faturave (depozitë).

b) për shtetas të huaj të cilët kanë leje për qëndrim të përkohshëm ose të vazhdueshëm në Republikën e Maqedonisë:

Kushte të përgjithshme

- Dokument për identifikim personal të lëshuar nga RM për shqyrtim (shqyrtim në Numrin e Vetëm Amë të RM), apo
  - Pagesën e depozitës në pajtim me dispozitat e nenit 6.8.
- c) për shtetas të huaj të cilët kanë leje qëndrimi në Republikën e Maqedonisë deri në 3 muaj:
- Dokument për identifikim personal për shqyrtim (pasaportë); dhe
  - pagesën e mjeteve në të holla si garanci për pagesën e rregullt të faturave (depozitë).
- ç) për shtetas të huaj me status diplomatik:
- dokument për identifikim personal në shqyrtim (letërnjoftim diplomatik apo zyrtar).

## 2) Personi juridik

- Certifikatë për gjendjen vijuese të subjektit juridik të lëshuar nga Regjistri Qendror i RMV-së, jo më e vjetër se 90 ditë.
  - Certifikatë banke jo më e vjetër se 1 (një) muaj për persona juridikë të cilët kërkojnë më shumë se 4 linja parapaguese dhe për persona juridikë të regjistruar në Regjistrin qendror të RMV-së në 24 muajt e fundit.
  - Dëshmi për pasjen e pronës (për linja parapaguese fikse nëse adresa e instalimit është ndryshe nga adresat e dhëna në gjendje vijuese të subjektit juridik).
  - Sipas nevojës, MKT ka të drejtë të kërkojë edhe bonitet, gjegjësisht raport për bilancin e gjendjes dhe të dhënat e bilancit të suksesit të vërtetuara nga Regjistri qendror.
- a) Persona juridikë të cilët nuk kanë xhiro llogari aktive:
- kërkesë e nënshkruar nga nënshkrues i autorizuar i personit juridik ose nga një i punësuar i autorizuar me autorizim special me shkrim për këtë qëllim të dhënë nga personi juridik;
  - certifikatë për gjendjen vijuese të subjektit juridik të dhënë nga Regjistri qendror i RM, jo më e vjetër se 6 muaj; dhe
  - pagesa e mjeteve si garanci për pagesën e rregullt të faturave (depozitë).
- b) Person juridik me status të vçantë:
- Një person i huaj juridik, mision ose organizatë ndërkombëtare mund të jetë parapagues nëse dorëzon garanci bankare në shumë prej 150.000,00 denarë.

Makedonski Telekom ka të drejtë t'i kontrollojë të dhënat personale dhe kapacitetin e pagesës së parapaguesit potencial para organeve kompetente. Makedonski Telekom është i obliguar që të gjitha të dhënat e nevojshme për përcaktimin e identitetit dhe kapacitetit pagesor të parapaguesit t'i ruajë dhe t'i shfrytëzojë vetëm për nevojat e veta.

Personi i cili dëshiron të krijojë marrëdhënie parapaguese me Makedonski Telekom, përveç plotësimit të kërkesës, me kërkesë të personit të autorizuar të Makedonski Telekom, është i obliguar që të dorëzojë një kopje, përkatësisht të paraqesë për kontroll dokumentet e përcaktuara në kërkesë. Makedonski Telekom, nëse është e nevojshme, mund të kërkojë dokumente të tjera shtesë nga parapaguesi.

3) Shtruesi për kontraktimin e marrëveshjes parapaguese në sistemin pripjd duhet ta paraqesë dokumentacionin vijues:

- për person fizik

a) një dokument identifikimi (letërnjoftim apo pasaportë);

- për person juridik

a) karton nënshkrimi për xhiro-llogarinë e personit juridik të lëshuar nga personi i autorizuar në bankën e depozituesit.

Makedonski Telekom, në përputhje me obligimin ligjor për të mbajtur evidencë për të gjitha marrëdhëniet e krijuara të parapaguesve me abonentët, ka të drejtë t'i mblodhë dhe regjistrojë këto të dhëna:

- emri, mbiemri dhe adresa, kurse për personin juridik selia e personit juridik; dhe

- numrin e identitetit ose numrin e dokumentit të udhëtimit, dhe për personin juridik një numër tatimor.

Parapaguesit e sistemit pripejd krijojnë një marrëdhënie parapaguese me operatorin në momentin e blerjes së kartës SIM me parapagesë nga pikat e autorizuar të shitjes së operatorit dhe përfaqësuesit e tij tregtarë dhe bëhet regjistrimi i të dhënave të tij.

Mbledhja dhe regjistrimi i të dhënave me qëllim të mbajtjes së evidencës për parapaguesit e sistemit pripejd do të bëhet nga Makedonski Telekom përmes:

(a) identifikimit e parapaguesit në vetë pikën e shitjes duke kontrolluar të dhënat nga një dokument identifikimi origjinal dhe i vlefshëm;

(b) thirrjen nga parapaguesi në një numër të caktuar posaçërisht ku ai do të jetë në gjendje të specifikojë të dhënat e kërkuara;

(c) një mënyrë tjetër e përcaktuar nga Operatori.

Qasja në shërbimet e ofruara nga Makedonski Telekom do të pamundësohet për parapaguesit e sistemit pripejd të Makedonski Telekom derisa të futen të dhënat e kërkuara. Përfundimi i vetëm është aftësia për të bërë thirrje dhe për të dërguar mesazhe të shkurtra me tekst në numrat e përcaktuar për të cilët mund të sigurohen të dhënat e kërkuara dhe në numrat e shërbimeve të thirrjeve të urgjencës.

Në rast të vërejtjes për saktësinë e të dhënave të regjistruara nga organi kompetent për një parapagues të caktuar të sistemit pripejd, Makedonski Telekom do ta njoftojë atë parapagues dhe do të kërkojë korrigjim duke futur të dhënat e sakta brenda 24 orëve pas pranimit të njoftimit, përmes mjeteve të mblledhjes dhe regjistrimit të të dhënave të përcaktuara më sipër. Nëse parapaguesi nuk dorëzon të dhëna të korrigjuara ose ka shënim të saktësisë për të dhënat e korrigjuara nga organi kompetent, Makedonski Telekom do ta pamundësojë qasjen në shërbimet që i ofron deri në futjen e të dhënave të sakta nga parapaguesi.

### (C) Kërkesa prioritare

Nëse mundësitë teknike kufizohen, kërkesat e shtruara në kushte të fatkeqësive elementare, ndonjë force madhore, gjendje lufte apo gjendje e jashtëzakonshme, plotësohen tek kërkeat e plotësuara nga:

- Organet e administratë shtetërore dhe njësitet e vetëqeverisjea lokale;
- Armata e RM-së;
- Organet shtetërore, organizata, institucione dhe ndërmarrje dhe shoqëri tregtare me autorizime publike;
- Mediat e veprimtarisë radiodifuzive.

### (Ç) Refuzimi/pezullimi i kërkesës

Makedonski Telekom mund ta refuzojë kërkesën për kontraktimin e marrëveshjes parapaguese në rastet vijuese:

- nëse ekzistojnë kufizime të cilat lidhen me kapacitetin dhe/apo mundësinë teknike;
- nëse nuk është paguar kompensimi për kycjen filleatare në afatin e paraparë;
- nëse shtruesi i kërkesës ka borxh të pashlyer ndaj Makedonski Telekomit;
- nëse përcaktohet se shtruesi i kërkesës nuk posedon aftësi pagesore;
- nëse shtruesi i kërkesës paraprakisht ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit ose ndonjë ligji apo rregulli tjetër, të konstatuar nga organi shtetëror kompetent;
- nëse shtruesi i kërkesës nuk i dorëzon dokumentet e nevojshme ose nuk i përmbush kushtet e parapara në kapitullin 7 neni 7.2. pika B;
- nëse Makedonski Telekom nuk mund ta konfirmojë besueahmërinë e ndonjërit prej dokumenteve të dhëna në kapitullin 7 neni 7.2. pika B.

Makedonski Telekom do ta njoftojë me shkrim shtruesin e kërkesës për refuzimin e kërkesës së tij në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, duke i cekur arsyet për refuzimin.

Makedonski Telekom mund ta pezullojë kërkesën për lidhjen e kontratës për parapagim për shkak të mungesës së mundësive teknike për realizimin e saj. Në këtë rast, kërkesa do të vendoset në listën e pritjeve në evidencën e Makedonski Telekomit deri në krijimin e mundësive teknike, pas së cilës do të aktivizohet për zgjidhje.

Me rastin e aktivizimit të kërkesës për lidhjen e kontratës parapaguese, shumica e kompensimit për kycje fillestare do të jetë sipas ofertës së vlefshme gjatë periudhës së aktivizimit të kërkesës.

### 7.3. Kontraktimi i marrëveshjes për marrëdhënien parapaguese

Pasi të sigurohet mundësia teknike dhe të bëhet pagesa brenda afatit të caktuar në emër të tarifës për kycje fillestare, marrëdhënia parapaguese ndërmjet Makedonski Telekom dhe parapaguesit konsiderohet se është krijuar në ditën e lidhjes së kontratës parapaguese. Marrëveshja do të konsiderohet e lidhur nga dita e nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese.

Ajo hyn në fuqi në ditën e aktivizimit të shërbimit të kërkuar të komunikimit, nga momenti kur fillon detyrimi për të paguar për shërbimet lëndë e Marrëveshjes.

Si rregull, kontrata lidhet për një kohë të pacaktuar, përveç nëse parapaguesi zgjedh të përdor shërbimin e komunikimit me kohëzgjatje të obligueshme të detyrimit të kontraktuar, për shkak të shfrytëzimit të ofertës speciale të Makedonski Telekomit. Makedonski Telekom ka obligim që ta njoftojë parapaguesin për skadimin e kohëzgjatjes së kontratës së lidhur në afat jo më të shkurtër se 30 ditë para skadimit të kohëzgjatjes së obligueshme të kontratës për parapagim. Nëse parapaguesi dëshiron ta ndërpresë kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes së saj, atëherë të gjitha obligimet që dalin nga kontrata ndaj Makedonski Telekomit do të paguhet menjëherë dhe para përfundimit, ai është i detyruar t'i shlyejë ato.

Si pjesë përbërëse e marrëveshjes parapaguese konsiderohen edhe formularët dhe anekset ndaj marrëveshjes që i plotëson dhe kontraktin parapaguesi, për aktivizimin dhe deaktivizimin e shërbimeve shtesë dhe për shkak të përcaktimit ose ndryshimit të modelit tarifor ose paketës që e përdorë.

Në rastin e nënshkrimit të kontratës parapaguese me një person fizik, kontrata duhet të nënshkruhet personalisht nga parapaguesi ose nëpërmjet një personi të autorizuar me autorizim të nostrifikuar te noteri.

Në rast të nënshkrimit të kontratës parapaguese me një person juridik, marrëveshja duhet të nënshkruhet nga nënshkruesi i autorizuar i personit juridik ose nga një punonjës i autorizuar për këtë qëllim me autorizim të veçantë të lëshuar nga personi juridik.

Makedonski Telekom ka të drejtë diskrecionale të vendosë për lidhjen e kontratës për parapagim me aplikuesin i cili nuk e posedon të gjithë dokumentacionin e përcaktuar me këto Kushte të përgjithshme.

Në kontratën e pajtimit shënohen të gjitha të dhënat përkatëse për parapaguesin të parashikuara me ligj. Parapaguesi është plotësisht përgjegjës për besueshmërinë e dokumentacionit dhe të dhënave që i paraqet për lidhjen e kontratës parapaguese. Në rast të ndryshimit të të dhënave personale ose të dhënave të tjera të futura në kontratën e parapagimit, parapaguesi është i obliguar ta njoftojë Makedonski Telekomin për ndryshimin menjëherë dhe më së voni në afat prej 15 ditësh. Nëse Makedonski Telekom për shkak të mospërmbushjes së këtij obligimi nuk mund të realizojë ndonjë obligim, të drejtë ose pëson dëme, përgjegjësia e përgjithshme për këtë bie mbi parapaguesin.

Pas kontraktimit fillestar të kontratës për parapagim për shfrytëzimin e shërbimeve të komunikimit celular të Makedonski Telekomit, çdo person fizik mund të jetë edhe bartës i më shumë se një linje parapaguese, me kusht që të gjitha faturat mujore për shfrytëzimin e linjave ekzistuese parapaguese që janë në emër të tij të jenë shlyer dhe se të mos ketë të konstatuar shkelje të rregullave për mënyrën e shfrytëzimit të shërbimeve të komunikimit elektronik të ofruara nga Makedonski Telekom.

Personi fizik nuk mund t'i pranojë më shumë se 5 (pesë) linja parapaguese në sistemin postpejd njëherësh gjatë lidhjes fillestare të kontratës parapaguese për shfrytëzimin e shërbimeve të komunikimit celular të Makedonski Telekomit, si dhe kur kërkon një numër shtesë të linjave të parapaguese, përveç me vendim të Makedonski Telekomit.

Çdo person fizik i cili do të kërkojë gjithashtu të jetë bartës i më shumë se një linje parapaguese në sistemin postpejd, mund ta bëjë këtë duke nënshkruar një formular "Bashkëngjitje në Marrëveshje" për secilën linjë parapaguese shtesë, ku do të konsiderohet pjesë përbërëse e marrëveshjes parapaguese me të cilën fillimisht ishte bazuar marrëdhënia parapaguese për atë person.

Kontrata parapaguese në bazë të së cilës një person fizik është bartës i më shumë linjave parapaguese në sistemin postpejd do të mbetet e vlefshme për sa kohë që ka të paktën një linjë aktive parapagimi në bazë të kësaj kontrate.

Telekom me përjashtim mund të përcaktojë mënyra të ndryshme të blerjes së linjave të reja parapaguese në modele të caktuara tarifore, për të cilat parapaguesi do të jetë i informuar siç duhet.

Pas lidhjes fillestare të kontratës parapaguese për shfrytëzimin e shërbimeve të komunikimit celular të Makedonski Telekom, çdo person juridik mund të kërkojë shtesë që të jetë mbajtës i më shumë se një linje parapaguese, me kusht që të gjitha faturat mujore për shfrytëzimin e linjave parapaguese që udhëhiqen në emrin e tij të jenë të shlyera.

Një person juridik nuk mund të marrë njëherësh më shumë se 5, 10 ose 50 linja parapaguese për modelet tarifore në sistemin postpejd, në varësi të segmentimit të cilit i përket, gjatë lidhjes fillestare të një kontrate parapaguese për shfrytëzimin e shërbimeve të komunikimit celular të Makedonski Telekomit, si dhe kur kërkohet numër shtesë i linjave të parapaguesve, përveç me vendim të Makedonski Telekomit.

Çdo person juridik që do të kërkojë gjithashtu të jetë zotërues i më shumë se një linje parapaguese në sistemin postpejd, mund ta bëjë këtë duke nënshkruar një formular "Bashkëngjitje ndaj Kontratës" për secilën linjë parapaguese shtesë, ku do të konsiderohet si pjesë përbërëse e marrëveshjes parapaguese me të cilën fillimisht ishte bazuar marrëdhënia parapaguese e atij personi.

Kontrata parapaguese në bazë të së cilës një person juridik është bartës i më shumë linjave parapaguese në sistemin postpejd do të mbetet valid derisa e ka të paktën një linjë aktive parapagimi në bazë të kësaj kontrate.

Me nënshkrimin e formularit përkatës "Bashkëngjitje ndaj Kontratës" për secilën linjë parapaguese veç e veç, përcaktimi i modelit tarifor që do ta përdorë parapaguesi, aktivizimi dhe çaktivizimi fillestar i shërbimeve të komunikimit të përfshira në modelin tarifor të zgjedhur nga parapaguesi, si dhe përcaktim i karakteristikave të linjës parapaguese. Të gjitha ndryshimet shtesë të linjës parapaguese rregullohen me formularë të veçantë.

#### 7.4. Kycja/Lidhja

Me nënshkrimin e Kontratës, Makedonski Telekom i siguron parapaguesit qasje në rrjetin publik të komunikimit dhe të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve bazë dhe shtesë të ofruara nga Makedonski Telekom sipas modelit/paketës tarifore të zgjedhur nga parapaguesi.

Qasja e parapaguesit në rrjetin e komunikimit të Makedonski Telekomit sigurohet me lidhjen e pajisjeve terminale përkatëse në pikën e kycjes në rrjet që është pronë e Makedonski Telekom.

Pika e lidhjes rrjetore në të cilën pajisja terminale është e lidhur me një rrjet publik fiks komunikimi mund të zbatohet edhe në ambientet e përdorura nga parapaguesi.

Makedonski Telekom e ka për obligim që në afat prej 30 ditësh nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes t'i lidhë pajisjet terminale të abonuesit në rrjetin publik të komunikimit. Në rast se kycja kryhet nga persona të autorizuar të Makedonski Telekom SHA - Shkup, parapaguesi është i obliguar që gjatë instalimit t'ua mundësojë hyrjen personave të autorizuar të Makedonski Telekom në hapësirat ku do të instalohen pajisjet terminale të parapaguesit.

Makedonski Telekom nuk do ta kufizojë apo kushtëzojë të drejtën e parapaguesve për kycje të pajisjeve terminale të miratuara nga autoritetet shtetërore. Pavarësisht nga sa u tha më lart, Makedonski Telekom nuk ka asnjë detyrim që të sigurojë ndërveprim të ndërsjellë të pajisjeve me rrjetet e tij të komunikimit, as nuk është përgjegjës për ndonjë humbje apo ndryshim të shkaktuar nga pajisjet terminale të ofruara nga palët e tjera.

Parapaguesi i nënshtrohet përgjegjësisë ndaj Makedonski Telekomit për çdo dëmtim të rrjetit të tij që mund të shkaktohet nga përdorimi i pajisjeve të paaprovuara.

Në çdo rast, Makedonski Telekom mund ta refuzojë lidhjen ose ndërprerjen e lidhjes me çfarëdo pajisje terminale që mund të shkaktojë probleme në rrjetin e tij.

Parapaguesi është i detyruar në llogari të tij të sigurojë një instalim shtëpie nga një kontraktues profesionist nga pika e lidhjes së rrjetit deri në dhomën ku janë instaluar pajisjet e komunikimit. Parapaguesi duhet të ketë një certifikatë vërtetimi për llojin e instalimit dhe pajisjes terminale, si dhe të sigurojë furnizimin e duhur me energji elektrike për pajisjen e komunikimit.

Makedonski Telekom është i obliguar që rregullisht t'i mirëmbajë kapacitetet e rrjetit të komunikimit që i posedon, në përputhje me rregullat dhe rregulloret teknike dhe planet për ruajtjen e shfrytëzimit të pandërprerë dhe të papenguar.

Parapaguesi është i obliguar të kujdeset për pajisjet terminale në pronësi të Makedonski Telekomit me kujdesin e një nikoqiri të mirë gjegjësisht pronari. Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies parapaguese, ai është i obliguar ta kthejë atë në gjendje të rregullt, rregullshmërinë e së cilës e konstatojnë personat e autorizuar nga Makedonski Telekom, për çka lëshohet dokument me shkrim.

#### 7.5. Shërbime komunikuese

Një shërbim i komunikimit elektronik mund të regjistrohet vetëm për një person. Një person mund të disponojë me shërbime të shumta të komunikimit elektronik, me kusht që të shlyhen të gjitha faturat mujore për përdorimin e shërbimeve ekzistuese të komunikimit që udhëhiqen në emër të tij. Shërbimi i komunikimit elektronik mund të ketë numrin/numrat e tij të posaçëm parapagues thirrës, që i mundëson parapaguesit të zgjedhë dhe të zgjidhet nga abonuesit dhe të krijojë komunikim me parapaguesit dhe përdoruesit e tjerë.

#### 7.6. Pajisja terminale parapaguese dhe instalimet

Në rrjetin fikse të komunikimit publik të Makedonski Telekom mund të kyçen vetëm pajisjet terminale që i plotësojnë kërkesat e standardeve teknike, performancës dhe shënjitimit, të përcaktuara në përputhje me ligjin dhe rregulloret pozitive.

Pajisjet dhe instalimet terminale të abonentit janë të vendosura në objektet në tokën e përdorur nga parapaguesi. Instalimi parapagues fillon nga pika e lidhjes në rrjet dhe përfundon në ambientet e parapaguesit, deri te pajisjet terminale të parapaguesit. Në objektet banesore me më shumë se gjashtë banesa dhe në objektet afariste, pika e lidhjes së rrjetit është në kabinën përçuese të ndërtesës kolektive.

#### 7.7. Ndryshime të Kontratës

Ndryshimet e marrëveshjeve parapaguese do të futen në aneksin ndaj marrëveshjes parapaguese, e cila nënshkruhet në mënyrë obligative nga të dyja palët.

### Kapitulli VIII

#### KUFIZIMI OSE NDËRPRERJA E QASJES NË SHËRBIMET E KOMUNIKIMEVE PUBLIKE

Nëse parapaguesi nuk i përmbush obligimet e tij kontraktuale, Makedonski Telekom ka të drejtë që përkohësisht ose përfundimisht t'i ndërpresë ose kufizojë shërbimet e tij, pas skadimit të periudhës përkatëse për të cilën parapaguesi do të informohet. Deri në ndërprerjen përfundimtare të shërbimeve, parapaguesit do t'i paguhet të gjitha tarifatat dhe taksat parapaguese.

#### 8.1. Kufizimi ose ndërprerja e shërbimeve komunikuese

Makedonski Telekom mund ta kufizojë ose ndërpresë përkohësisht qasjen në shërbimet publike të komunikimit elektronik në rastet e mëposhtme:

- nëse është e nevojshme për qëllime rikonstruksioni, modernizimi, mirëmbajtjeje ose në rast të pengesave teknike ose mangësive në rrjet, deri në përfundimin e punimeve ose heqjen e pengesave;;
- nëse konstatohen pengesa teknike ose mangësi të pajisjeve ose instalimeve terminale parapaguese, deri në eliminimin e këtyre pengesave, gjegjësisht mangësive;
- nëse parapaguesi nuk e paguan faturën për përdorimin e shërbimeve brenda afatit të pagesës të përcaktuar në faturë, deri në pagesën e plotë të faturës, përveç në rast të ankesës së shtruar për shumën e faturës, kur parapaguesi duhet ta paguaj shumën e parapagesis mujore deri në datën e dhënë në faturë, deri në vendimin final pas ankesës;
- nëse parapaguesi e shfrytëzon linjën parapaguese dhe shërbimet përkatëse të komunikimit për të ofruar shërbime të komunikimit personave të tjerë me kompensim dhe pa lidhur kontratë përkatëse me Makedonski Telekom;
- nëse konstaton ose ka dyshime se parapaguesi ka përfituar në mënyrë të paligjshme me linjën parapaguese
- nëse pajtimtari nuk lejon inspektimin e rregullshmërisë së pajisjeve ose instalimeve të tij terminale, derisa të kryhet inspektimi;
- nëse parapaguesi lidh pajisje terminale që nuk përputhet me rregulloret në fuqi;
- nëse shërbimi i komunikimit publik përdoret ose dedikohet të përdoret për qëllime në kundërshtim me Ligjin për Komunikimet Elektronike, rregulloret e miratuara në bazë të tij ose një ligji apo rregulloreje tjetër, të konstatuar nga organi kompetent;
- nëse shërbimi i komunikimit publik përdoret ose dedikohet të përdoret për një qëllim në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes parapaguese.

Makedonski Telekom në mënyrë elektronike, me shkrim ose përmes mjeteve të informimit për rastet e kufizimit të përkohshëm ose ndërprerjes së qasjes në shërbimet e komunikimit të përcaktuara në paragrafin 1, alinea 1 dhe 2 të këtij neni, të cilat zgjasin më shumë se 30 minuta, i njofton abonuesit dhe Agjencinë për komunikime elektronike të paktën 48 orë përpara kufizimit ose ndërprerjes së planifikuar të qasjes, si dhe jo më shumë se 48 orë pas ndërprerjes në rastin e kufizimeve ose ndërprerjeve të shkaktuara nga pengesa teknike ose mangësi në rrjet.

Në rast të ndërprerjes së ofrimit të shërbimeve publike të komunikimit për shkak të defektit për të cilin Makedonski Telekom nuk është përgjegjës, i njofton abonuesit për kohën e pritur për heqjen e defektit dhe për riangazhimin e tyre në komunikacionin e komunikimit.



Me rastin e punëve teknike të planifikuara dhe ndërhyrjeve të punës, të cilat kanë të bëjnë me ndërhyrje në rrjet dhe pajisje, Makedonski Telekom menjëherë u dërgon abonuesve dhe Agjencisë informatike për arsyet e shkyçjes, kohën e shkyçjes dhe kycjes së sërishme.

Makedonski Telekom i merr të gjitha masat e nevojshme që kufizimet apo ndërprerjet të zgjasin sa më shkurt.

Makedonski Telekom nuk është i obliguar që paraprakisht ta informojë parapaguesin për shkyçjen, nëse:

- një kërcënim të menjëhershëm dhe serioz për rendin publik, sigurinë publike, shëndetin e njerëzve dhe mjedisin ose
- shkakton dëme të mëdha materiale ose operationale.

Nëse është teknikisht e mundur, Makedonski Telekom ka të drejtë ta kufizojë qasjen vetëm në ato shërbime në lidhje me të cilat parapaguesi nuk ka vepruar sipas kushteve të përcaktuara në kontratën parapaguese, përveç në rastet e keqpërdorimeve të konstatuara nga organi kompetent shtetëror dhe në vonesa në vazhdimësi të pagesës ose mospagesës së faturës.

## 8.2. Procedura për ndërprerjen e sigurimit të shërbimeve komunikuese për shkak të mospagesës

### 8.2.1. Procedura për ndërprerjen e shërbimeve fikse të komunikimit elektronik

Makedonski Telekom në përputhje me Marrëveshjen, do ta ndërpresë ofrimin e shërbimeve të komunikimit për shkak të pagesës së faturës jo në kohë, duke e respektuar procedurën e shkyçjes.

Në rast të pagesës jo në kohë, Makedonski Telekom ka të drejtë të llogarisë kamatvonesë nga dita kur parapaguesi ka rënë në vonesë me pagesën.

Nëse parapaguesi nuk e paguan faturën për përdorimin e shërbimeve brenda afatit të pagesës të përcaktuar në faturë, Makedonski Telekom, pas njoftimit paraprak të parapaguesit për shlyerjen e borxhit të tij, ka të drejtë të ndërpresë përkohësisht qasjen në shërbimet në një telefonatë dalëse, deri në shlyerjen e plotë të borxhit nga parapaguesi. Gjatë ndërprerjes së shërbimit në një drejtim, abonimi muajor vazhdon të rrjedhë.

Nëse abonuesi nuk e paguan borxhin edhe pas 15 ditësh nga pezullimi i përkohshëm, Makedonski Telekom mund të ndalojë qasjen në shërbimet në dy drejtime dhe nga ai moment Makedonski Telekom nuk do të faturojë parapagesën mujore.

Makedonski Telekom, gjatë ndërprerjes së përkohshme të shërbimeve nga ky nen, nuk guxon ta kufizojë qasjen dhe përdorimin e numrave të shërbimeve të thirrjeve emergjente.

Makedonski Telekom do ta rilidh parapaguesin në kohën më të shkurtër të mundshme, pas paraqitjes së dëshmisë me shkrim ose në mënyrë elektronike për shlyerjen e borxhit të vonuar.

Nëse parapaguesi nuk e paguan borxhin edhe brenda 80 ditëve pas skadimit të afatit të pagesës të përcaktuar në faturë, Makedonski Telekom ka të drejtë ta ndërpresë Kontratën dhe të qaset drejt ndërprerjes përfundimtare të shërbimeve.

Me ndërprerjen përfundimtare të shërbimit, marrëdhënia parapaguese përfundon.

### 8.2.2. Procedura për ndërprerjen e shërbimeve celulare të komunikimit elektronik

Nëse parapaguesi nuk e paguan faturën për shfrytëzimin e shërbimeve brenda afatit të caktuar për pagesë, pas njoftimit paraprak me shkrim, Makedonski Telekom ka të drejtë:

- ta kufizojë qasjen në shërbimet e tij bazë dhe/ose shtesë, në shërbimet me një çmim të veçantë kostoje dhe shërbime të tjera, përveç qasjes dhe përdorimit të numrave të shërbimit të thirrjeve emergjente, dhe/ose
- ta shkyç parapaguesin dhe ta ndërpresë marrëveshjen parapaguese në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në të.

Ndërsa linja është e ndërprerë në një drejtim, vetëm për thirrjet dalëse, parapagesa mujore vazhdon të rrjedhë.

Kycja e serishme e linjës parapaguese pas pagesës së të gjithë borxhit bëhet në afat prej 1 ditë pune pasi pagesa të jetë regjistruar për pagesë në llogarinë e Makedonski Telekomit ose pasi parapaguesi të ketë dorëzuar dëshminë për pagesën e tërë borxhit në numrin përkatës të telefonit të publikuar nga Makedonski Telekom.

Me rastin e rikycjes pas shlyerjes së borxhit, parapaguesi është i obliguar të paguajë kompensimin për kycjen e serishme të linjës parapaguese që përkohësisht është shkëputur për shkak të mospagesës, në përputhje me Çmimoren e Makedonski Telekomit.

Nëse parapaguesi nuk e paguan borxhin as në afatin prej 30 ditësh nga dita e shkyçjes së përkohshme të linjës për thirrjet dalëse, linja do të ndërpritet, nga i cili moment Makedonski Telekom nuk do ta faturojë parapagimin muajor.

Nëse parapaguesi nuk e paguan borxhin edhe në afat prej 3 (tre) muajsh nga dita e shkyçjes së përkohshme të linjës, Makedonski Telekom ka të drejtë ta ndërpresë kontratën e parapagimit.

Nëse parapaguesi nuk e paguan borxhin e vonuar vullnetarisht, Makedonski Telekom ka të drejtë t'i ndërmarrë të gjitha masat ligjore për pagesën e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të borxhit si dhe për iniciimin e procedurës për pagesë të detyrueshme të borxhit.

### 8.3. Pagesa e kërkesave në mënyrë gjyqësore

Nëse parapaguesi nuk e paguan borxhin e mbetur për shfrytëzimin e shërbimeve të komunikimit pas veprimeve të ndërmarra më parë: paralajmërime, shkyçje të përkohshme dhe shkyçje të plotë - demontim, Makedonski Telekom ka të drejtë të ndërmarrë veprime për pagesën e kërkesave financiare në rrugë gjyqësore.

### 8.4. Ndërprerje e përkohshme në sigurimin e shërbimeve të komunikimit (Pezullim)

Makedonski Telekom, me kërkesë me shkrim të parapaguesit, mund ta ndërpresë përkohësisht ofrimin e shërbimeve të komunikimit për një periudhë prej 30 ditësh deri në tre muaj, por jo më shumë se një herë në vit dhe gjatë së cilës kohë nuk paguhet parapagimi i rregullt mujor. Kycja e sërishme do të kryhet pas skadimit të afatit ose më parë duke paraqitur një kërkesë me shkrim për aktivizimin e shërbimit. Pas përfundimit të periudhës së pezullimit, parapaguesi do të vazhdojë ta përdorë modelin ose paketën tarifore që e ka përdorur përpara periudhës së pezullimit. Parapaguesi paguan kompensim për shërbimin në përputhje me Çmimoren e Makedonski Telekomit.

### 8.5. Shkyçja e shërbimeve të komunikimit gjatë falimentimit dhe likuidimit

Makedonski Telekom e ndjek “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe në rast të falimentimit, riorganizimit, likuidimit apo jolikuiditetit të parapaguesit, gjegjësisht insolvencës së parapaguesit, do ta bëjë demontimin e linjës së parapaguesit, gjegjësisht do ta ndërpresë kontratën e parapaguesit, nëse ka të drejtë për ta shfrytëzuar shërbimin nuk i është bartur personit tjetër në afat prej 2 muajsh nga dërgimi i paralajmërimit me shkrim nga Makedonski Telekom. Në rast të falimentimit aktiv, nëse parapaguesi vazhdon edhe më tej ta paguajë borxhin, Makedonski Telekom do të lejojë përdorimin e një numri të caktuar të shërbimeve minimale të komunikimit me kërkesë të parapaguesit.

### 8.6. SIM kartelë e humbur ose e vjedhur

Në rast të humbjes, vjedhjes ose dëmtimit të pjesshëm ose shkatërrimit të plotë të SIM kartelës, ose nëse ekziston dyshimi i bazuar se numri i tij personal i koduar është zbuluar nga palët e treta, parapaguesi është i obliguar që menjëherë ta informojë Makedonski Telekomin me qëllim që përkohësisht ta shkëpusë linjën parapaguese në drejtimin dalës dhe/ose hyrës. Operatori do të veprojë për njoftimin e parapaguesit duke e shkëputur linjën në dy drejtime (trafikun hyrës dhe dalës) ndërkohë që parapagimi mujor do të vazhdojë të rrjedhë. Ky status i linjës parapaguese do të jetë i vlefshëm brenda 30 ditëve. Gjatë 30 ditëve nga dita kur SIM kartela e humbur ose e vjedhur është shkëputur nga shërbimet kompetente të Operatorit, Parapaguesi mund të kërkojë ndërrimin e kësaj karte SIM. Nëse Parapaguesi nuk kërkon zëvendësimin e kartës SIM të humbur ose të vjedhur, pas skadimit të periudhës së caktuar prej 30 ditësh, parapagimi mujor do të ndalojë së funksionuari dhe Operatori ka të drejtë të ndërpresë këtë Marrëveshje. Parapaguesi është i detyruar t'i paguajë shpenzimet e bëra nga përdorimi i kartës së humbur ose të vjedhur deri në momentin e vërtetimit të raportimit të vjedhjes ose humbjes së kartës SIM. Parapaguesi i kompenson shpenzimet e ndërrimit të kartës SIM dhe rilldhjes së saj me rrjetin në përputhje me Çmimoren e Operatorit. Parapaguesi duhet të kthejë kartën SIM sa herë që Operatori i kërkon një gjë të tillë prej tij dhe veçanërisht në rastet kur kjo kërkohet për arsye sigurie, gjendje të jashtëzakonshme ose kur është me interes publik, si dhe për arsye që lidhen me funksionimin e rrjetit.

## Kapitulli IX

### SHËRBIME TË TJERA

#### 9.1. Zhvendosja e linjës parapaguese me kërkesë të parapaguesit

Parapaguesi ka të drejtë ta zhvendosë lidhjen, përkatësisht shërbimin e komunikimit brenda rrjetit publik të komunikimit në një adresë tjetër, në të njëjtën ose në një zonë tjetër numerike të Makedonski Telekomit, me kërkesë me shkrim dhe pas shlyerjes së borxhit paraprak.

Nëse teknikisht është e mundur, Makedonski Telekom do ta kryejë transferimin me të njëjtin numër ose me një numër tjetër në afat prej 15 ditësh.

Nëse zhvendosja teknikisht nuk është e mundur, shërbimi do të shkëputet nga rrjeti publik i komunikimit dhe abonuesi do ta ketë statusin e parapaguesit, marrëdhënia parapaguese e të të cilit është pezull. Me kërkesën për zhvendosje është e nevojshme të paraqitet për kontroll dhe dokumentacioni përkatës (dëshmi pronësie ose marrëveshje qiraje) për hapësirën që ndodhet në adresën ku kërkohet zhvendosja. Në rast se marrëdhënia parapaguese vihet në pritje, parapaguesi nuk paguan parapagim mujor.

Për zhvendosjen e shërbimit të komunikimit, parapaguesi paguan shpenzimet për instalimin e pajisjeve terminale në rrjetin publik të komunikimit të Makedonski Telekomit, në adresën në të cilën ai shpërngulet, në përputhje me çmimoren e Makedonski Telekomit.

Parapaguesit që kanë fatura të papaguara të Makedonski Telekom nuk mund të transferojnë linjën e parapagimit në adresë tjetër.

#### 9.2. Ndryshimi i numrit parapagues

Secila linjë e parapaguese merr numrin e vet të parapaguesit, të cilin e cakton Makedonski Telekom, pas vendimit të marrë paraprakisht për caktimin e numrave dhe serive të numrave nga Agjencia për Komunikime Elektronike në pajtim me Planin e numrave për rrjetet dhe shërbimet e komunikimit publik në Republika e Maqedonisë.

Makedonski Telekom mund ta ndryshojë numrin parapagues të linjës së parapaguesve për shkaqe teknike, pa pëlqimin e parapaguesit, me njoftim me shkrim së paku 30 ditë para ndryshimit. Në këtë rast, parapaguesi nuk ka të drejtë për kompensim për dëmin e shkaktuar si rezultat i ndryshimit të numrit thirrës të abonuesit.

Numri i vjetër i thirrjes nuk i caktohet një parapaguesi tjetër për një periudhë prej të paktën 30 ditësh. Në sistemet në të cilat ka mundësi teknike jepen njoftime zanore për ndryshimin e numrave, në mënyrë që për një periudhë 30-ditore çdo telefonatë e bërë nga numri i vjetër jepet njoftim për ndryshimin e bërë me informacion për numrin e ri. Për parapaguesit – persona juridikë, njoftimi për ndryshimin e numrave bëhet brenda 60 ditëve.

Numri i parapaguesit mund të ndryshohet me kërkesë të parapaguesit duke shtruar kërkesë me shkrim në Makedonski Telekom, nëse parapaguesi i ka shlyer të gjitha obligimet ndaj Makedonski Telekomit paraprakisht. Parapaguesi mund të kërkojë ndryshime në numrin e parapaguesit të linjës parapaguese ndërsa Makedonski Telekom, si rregull, e miraton nëse ka mundësi teknike për të. Për të njëjtin shërbim, Makedonski Telekom mund të paguaj kompensim përkatës, në përputhje me Çmimoren.

Parapaguesi mund të deklarohet nëse dëshiron që numri i ri i parapaguesit të komunikohet nga Shërbimi Informativ dhe të publikohet në numratorin telefonik të Makedonski Telekomit.

### 9.3. Ndryshimi i emrit të parapaguesit në adresë të njëjtë (personi fizik)

Me kërkesë të parapaguesit, nëse i ka shlyer borxhet ndaj Makedonski Telekom për shërbimet e përdorura të komunikimit, me kompensim, linja mund të ndryshohet (regjistrohet) në emër të personit tjetër pa e zhvendosur linjën në adresë tjetër në rastet në vijim:

- kur parapaguesi e ka ndryshuar emrin e tij;
- kur linja regjistrohet në emër të një familjari me pëlqimin e tij;
- Nëse ndryshimi bëhet në rast të vdekjes së parapaguesit, linja mund t'i regjistrohet një personi tjetër, përkatësisht:
- anëtar i të ngushtë të familjes (bashkëshorti, babai, nëna, djali ose vajza);
- një personi bazuar në një vendim gjyqësor të plotfuqishëm.

Kërkesa për riemërtimin e parapaguesit duhet t'i dorëzohet Makedonski Telekom në afat prej 6 muajsh nga vdekja e parapaguesit me një shtojcë të vendimit gjyqësor të plotfuqishëm.

Parapaguesi duhet të paguajë kompensimin për shërbimin në shumën e përcaktuar me Çmimoren e Makedonski Telekomit.

### 9.4. Ndryshimi i emrit të parapaguesit (personit juridik), ndarja e një personi juridik në një ose më shumë persona juridikë (pasardhësit juridikë)

Në rast të ndryshimit të statusit të personave juridikë, linja mund të reregjistrohet në emër të pasardhësit ligjor nëse është paraqitur kërkesë me shkrim për këtë.

Shoqëria e sapoformuar ose tregtari individual, që të mund ta përdorë të drejtën e linjës parapaguese, e ka detyrimin brenda 15 ditëve nga dita e transformimit të bërë, të paraqesë prova materiale, me çka do ta vërtetojë lidhjen me personin juridik pasardhës ligjor i së cilit është.

Subjekti juridik i sapoformuar e dorëzon në Makedonski Telekom dokumentacionin në vijim:

- Vendim për regjistrimin nga Regjistri Qendror;
- **Kartoni për nënshkrimin e depozituar;**
- **Kopje e marrëveshjes së hapësirës afariste ose marrëveshjes së qirasë.**

Parapaguesi duhet të paguajë kompensim për shërbimin në shumën e përcaktuar me Çmimoren e Makedonski Telekomit.

Parapaguesi pasardhës do të jetë përgjegjës për pagesën e të gjitha shpenzimeve të bëra nga parapaguesi paraardhës, të cilat mund të jenë faturuar me vonesë ose janë faturuar dhe nuk janë paguar nga parapaguesi.

### 9.5. Bartja e të drejtës së përdorimit të linjës parapaguese

Parapaguesi mund t'ia kalojë të drejtën e përdorimit të linjës parapaguese një tjetër parapaguesi që e cakton vetë, nëse ai person i plotëson kushtet për marrjen e linjës parapaguese dhe e paraqet dokumentacionin e parashikuar në pikën 7.2. (B).

Parapaguesi është i detyruar të shlyejë të gjitha faturat mujore të lëshuara deri atëherë për përdorimin e linjës parapaguese.

Parapaguesi duhet të paguajë kompensim për bartjen e së drejtës së shfrytëzimit në shumën e përcaktuar me Çmimoren e Makedonski Telekomit.

Kompensimi nuk paguhet vetëm në rastet e mëposhtme:

- a) kalimi i së drejtës tek bashkëshorti ose anëtarët e familjes së ngushtë (prindi, fëmija);
- b) kalimin e së drejtës në rast vdekjeje të parapaguesit;
- c) kalimi i së drejtës në rast të përfundimit të personit juridik - parapagues (likuidim ose falimentim),
- ç) kalimi i së drejtës në rast të ndryshimeve statusore në personin juridik (ndarje, bashkim, aneksim) dhe

e) kalimi i së drejtës nga një person juridik te një person fizik ose anasjelltas kur personi fizik është themelues ose ortak në personin juridik.

Bartja e së drejtës së shfrytëzimit bëhet me lidhjen e aneksit të marrëveshjes për parapagim, e cila lidhet ndërmjet Makedonski Telekom, parapaguesit dhe parapaguesit pasardhës, në të cilën janë dhënë të gjitha obligimet e tjera të marra nga parapaguesi pasardhës (borxhi i mbetur, marrëveshjet e besnikërisë, tandem linjat etj.). Një kopje e marrëveshjes së vlefshme standarde të parapaguesit të Makedonski Telekomit, dispozitat e së cilës do të zbatohen për parapaguesin pasardhës, i bashkëngjitet aneksit.

Në rast të kalimit të së drejtës së përdorimit të linjës parapaguese për shkak të vdekjes së parapaguesit, aneksi i kontratës zëvendësohet me një kërkesë me shkrim të trashëgimtarit në zotërimin e të cilit është karta SIM për të shkarkuar linjën parapaguese duke i bashkëngjitur një certifikatë nga regjistri i të vdekurve. Në një rast të tillë, parapaguesi-pasardhës duhet të nënshkruajë pajtim me të gjitha obligimet që i merr (borxhin e mbetur, marrëveshjet e besnikërisë, linjat tandem, etj.) Ndaj pajtimit të nënshkruar bashkohet edhe një ekzemplar i marrëveshjes standarde parapaguese të Makedonski Telekomit, dispozitat e së cilës do të zbatohen për parapaguesin pasardhës.

Para nënshkrimit të aneksit ose pëlqimit, të gjitha faturat mujore të papaguara për përdorimin e shërbimeve, si dhe shpenzimet e bëra në muajin aktual deri në nënshkrimin e aneksit ose pëlqimit, duhet të shlyhen paraprakisht nga parapaguesi-pasardhës.

Parapaguesi - pasardhës do të jetë përgjegjës për pagesën e faturave mujore të lëshuara pas nënshkrimit të aneksit.

Parapaguesi pasardhës do të jetë në mënyrë solidare dhe individualisht përgjegjës për pagesën e të gjitha shpenzimeve që janë bërë nga parapaguesi i mëparshëm, dhe të cilat mundësisht janë faturuar me vonesë, ose janë faturuar dhe nuk janë paguar nga parapaguesi.

#### 9.6. Ndryshimi i të dhënave të parapaguesit

Parapaguesi është i detyruar të njoftojë Makedonski Telekomin me shkrim për ndryshimet në të dhënat personale, emrin, titullin, adresën, vendin, statusin ose të dhënat e natyrës identifikuese brenda 15 ditëve nga ndryshimi dhe për dëmet e shkaktuara nga mospërputhja e detyrimit, përgjegjësinë do ta bart parapaguesi.

#### 9.7. Ndryshime të shërbimeve

Nëse vjend drejt ndryshimit të shërbimeve, çmimet e shërbimeve dhe mënyrën e tarifimit të të njëjtave si edhe kushtet e tjera të punës, paraprakisht, në afat jo më të shkurtër se 30 (tridhjetë) ditë ta njoftojë parapaguesin në formë të shkruar.

#### 9.8 . Shërbime që do t'i sigurojnë operatorët/ ofruesit e tjerë të shërbimeve komunikuese

Makedonski Telekom nuk është përgjegjës për cilësinë e shërbimeve të ofruara për parapaguesit e Makedonski Telekomit nga operatorë të tjerë dhe/ose ofrues të shërbimeve të komunikimit, duke e përdorur rrjetin e Makedonski Telekomit. Përdorimi i shërbimeve që operatorët e tjerë/ofruesit e shërbimeve të komunikimit i ofrojnë përmes rrjetit të Makedonski Telekomit i nënshtrohet kushteve të përcaktuara nga ai operator/ofrues i shërbimeve të komunikimit.

Shërbime të tjera

#### 9.9. Kalimi i numrit ose ndryshimi i operatorit të rrjetit publik fiks ose celular të komunikimit elektronik.

##### 9.9.1. Obligimet e Makedonski Telekomit, kur ai paraqitet si operator ofrues

Makedonski Telekom ka për obligim që të sigurojë bartjen e numrit parapagues fiks tek operatori i rrjetit publik telefonik fiks dhe bartjen e numrit nga rrjeti publik i komunikimit elektronik celular me operator të rrjetit publik të komunikimit elektronik celular.

Makedonski Telekom ka për obligim që të sigurojë vazhdimësi të shërbimeve deri në fillimin e afatit për dorëzimin e numrit.

Parapaguesi shtron kërkesë për lidhjen e një kontrate parapaguese duke i transferuar një numër operatorit marrës. Me paraqitjen e kërkesës, parapaguesi e ndërpret Marrëveshjen parapaguese të lidhur me Makedonski Telekom SHA - Shkup, dhe operatori pranues në emër të tij i dorëzon të dhënat e nevojshme personale dhe pëlqimin e nënshkruar nga parapaguesi deri tek Makedonski Telekom SHA.

Operatori pranues përmes sistemit CBP do ta njoftojë Makedonski Telekomin se parapaguesi ka dorëzuar kërkesë për lidhjen e kontratës së parapagimit me bartjen e numrit në afat prej jo më të gjatë se 2 (dy) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës, përveç në raste kur operatori marrës duhet të përcaktojë paraprakisht nëse ekziston mundësia teknike për ta zbatuar kërkesën për lidhjen e një kontrate parapaguese duke e transferuar një numër.

Nëse kërkesa për transferim të numrit përmes sistemit CBP pranohet nga Makedonski Telekom deri në orën 12:00 të ditës së punës, Makedonski Telekom do t'i përgjigjet operatorit marrës brenda një periudhe jo më të gjatë se 3 (tre) orë pas pranimit të kërkesës për lidhjen e një kontrate parapaguese duke transferuar një numër. Nëse Makedonski Telekom nuk i përgjigjet kërkesës në afat prej 3 (tre) orësh, kjo nënkupton se kërkesa është pranuar.

Nëse kërkesa për transferim të numrit përmes sistemit CBP nga Makedonski Telekom SHA pranohet pas orës 12:00 gjatë ditës së punës ose në ditë jopune, Makedonski Telekom do t'i përgjigjet operatorit pranues në afat jo më të gjatë se 3 (tre) orë nga fillimi i orarit të punës në ditën e ardhshme të punës. Nëse Makedonski Telekom nuk i përgjigjet kërkesës brenda 3 (tre) orëve të parapara, kjo nënkupton se kërkesa është pranuar.

Afati kohor për dorëzimin e numrit është periudha kohore nga ora 12:00 deri në orën 16:00 çdo ditë pune e cila fillon brenda 2 (dy) ditëve të punës me rastin e transferimit të numrit fiks të abonentit ose brenda 1 (një) dite gjatë transferimit të një numri celular, që nga momenti i transaksionit të regjistroj të dhënat për transferimin e numrit në CBP për kontratën specifike parapaguese të lidhur nga operatori marrës dhe fillon ofrimi i shërbimit nga operatori marrës. Gjatë kësaj periudhe ofrimi i shërbimit mund të ndërpritet pjesërisht ose plotësisht.

Në rast të kërkesës për bartjen e më shumë se 1000 numrave tek një parapagues, Makedonski Telekom mund të kërkojë pëlqimin e Agjencisë për vazhdimin e afatit për fillimin kornizës kohore për bartjen e numrave.

Në rastin e transferimit të numrave në të njëjtën kohë me qasje të ndarë në linjën lokale ose linjën e parapaguesve me shumicë, Makedonski Telekom dhe operatori pranues bien dakord për datën e zbatimit së qasjes së ndarë në linjën lokale ose shërbimin me shumicë për marrjen me qira të linjës së parapaguesve me transferim të numrit, e cila periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se 10 (dhjetë) ditë pune nga dita e paraqitjes së kërkesës për lidhjen e marrëveshjes me transferimin e numrit të operatorit të përdoruesit nga parapaguesi.

Makedonski Telekom duhet të ofrojë mundësinë që parapaguesve t'ij si palë thirrëse të informohen para fillimit të thirrjes nga rrjeti i Makedonski Telekomit nëse dhe në cilin rrjet është bartur numri nga rrjeti i Makedonski Telekomit, përmes numrit thirrës në shërbimin e kujdesit ndaj klientit. Kur një Parapagues inicion një telefonatë në një numër të transferuar, para se ta kryejë thirrjen, Makedonski Telekom duhet të sigurojë që abonentët e tij marrin një sinjal zanor që nuk do të zgjasë më shumë se 2 (dy) sekonda, i cili pa mëdyshje përcakton se Parapaguesi po thërret një numër të transferuar.

Makedonski Telekom do t'i paguaj parapaguesit kompensim të njëfishtë për mbulimin e shpenzimeve të bartjes së numrave në rast të bartjes së numrit gjatë ndërrimit të operatorit të rrjetit publik të komunikimit, të përcaktuar në Çmimoren e Makedonski Telekomit.

#### 9.9.2. Obligime të parapaguesit kur Makedonski Telekom paraqitet si operator ofrues

Parapaguesi duhet të pajtohet që kontrata parapaguese e lidhur me Makedonski Telekomin të ndërpritet për shkak të ushtrimit të së drejtës së parapaguesit për transferim të numrit. Për këtë qëllim, parapaguesi nënshkruan kërkesë për lidhjen e një kontrate parapaguese duke e transferuar një numër që e paraqet deri te operatori marrës.

Kontrata e parapagimit me Makedonski Telekomin ndërpritet me bartjen faktike të numrit. Pas bartjes së numrit, parapaguesi është i obliguar që t'i shlyejë të gjitha obligimet për shkepjetjen e kontratës së parapagimit ndaj Makedonski Telekomit, të cilat i kishte deri në momentin e bartjes faktike të numrit.

Parapaguesi mund të paraqesë një kërkesë për transferimin e një, më shumë ose të gjithë numrave të përfshirë në kontratën parapaguese.

Parapaguesi ka të drejtë të ritransferojë numrin e transferuar në cilindo operator tjetër, përfshirë Makedonski Telekomin dhe çdo operator të mëparshëm pas skadimit të 30 ditëve nga dita e fillimit të shërbimit pas transferimit të mëparshëm.

#### 9.9.3. Obligime të Makedonski Telekomit, kur paraqitet si operator pranues

Makedonski Telekom është i obliguar ta pranojë kërkesën e parapaguesit për bartjen e numrit parapagues në rrjetin e tij publik elektronik fiks ose celular, nëse parapaguesi i plotëson dispozitat e përcaktuara në Kushtet e përgjithshme.

Makedonski Telekom përmes sistemit CBP do ta njoftojë operatorin- ofrues se parapaguesi ka paraqitur kërkesë për lidhjen e kontratës për parapagim me bartjen e numrit në afat prej jo më të gjatë se 2 (dy) ditë pune nga dita e pranimit të kërkesës nëse ekzistojnë kushte teknike për ofrimin e shërbimeve të kërkuara nga Parapaguesi. Makedonski Telekom ka të drejtë për një periudhë më të gjatë për njoftimin e Operatorit ofrues në rast se nevojiten aktivitete shtesë për të përcaktuar ekzistimin e mundësive teknike për ofrimin e shërbimeve të kërkuara nga Parapaguesi. Operatori- ofrues përmes sistemit CBP duhet t'i përgjigjet Makedonski Telekomit në afat jo më të gjatë se 3 (tre) orë pas pranimit të kërkesës.

Në rast refuzimi të kërkesës, pas përmbushjes së detyrimeve që kanë qenë shkak i refuzimit, parapaguesi e paraqet një kërkesë të re për lidhjen e kontratës parapaguese duke e transferuar një numër.

Në rast të pranimit të kërkesës për transferim të numrit, marrëveshja parapaguese e lidhur me Makedonski Telekom hyn në fuqi në momentin e bartjes reale të numrit nga Operatori - ofrues.

Korniza kohore për dorëzimin e numrit është periudha kohore nga ora 12:00 deri në orën 16:00 çdo ditë pune e cila fillon brenda 2 (dy) ditëve pune me rastin e transferimit të numrit fiks të parapaguesit ose brenda 1 (një) dite pune gjatë transferimit të një numri të celularit, nga momenti i transaksionit për regjistrimin e të dhënave për bartjen e numrit në CBP nga Makedonski Telekom dhe fillon ofrimi i shërbimit nga Makedonski Telekom në bazë të marrëveshjes së lidhur parapaguese me transfer të numrit. Gjatë kësaj periudhe ofrimi i shërbimit mund të ndërpritet pjesërisht ose plotësisht.

#### 9.9.4. Obligime të parapaguesit, kur Makedonski Telekom paraqitet si operatues pranues

Kërkesën për lidhjen e kontratës për parapagim, parapaguesi e paraqet me transferimin e një numri në sallonet e shitjes së Makedonski Telekomit. Para paraqitjes së kërkesës nga paragrafi i mëparshëm, parapaguesi duhet ta sigurojë dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në nenin 7.2 të këtyre Kushteve të përgjithshme dhe të marrë njoftimin për mundësinë teknike të transferimit të një numri.

Parapaguesi i shërbimeve publike të komunikimit celular ka të drejtë të iniciojë kalimin e numrit/linjës parapaguese nga modeli tarifor pripejd në modelin tarifor postpejd të Makedonski Telekomit duke paraqitur kërkesë përkatëse për këtë të lëshuar nga Makedonski Telekom, me çka aprovimi i kërkesës do të kryhet në përputhje me dispozitat e nenit 7.2 të këtyre Kushteve të përgjithshme.

## 9.10. Bartja gjeografike e numrit

Makedonski Telekom do të sigurojë bartje gjeografike të numrit të parapaguesit i cili dëshiron ta mbajë numrin ekzistues gjatë ndërrimit të pikës përfundimtare të rrjetit në të njëjtën zonë numerike, pas paraqitjes së kërkesës për zhvendosje duke e mbajtur numrin ekzistues gjatë ndryshimit të pikës përfundimtare të rrjetit në të njëjtin rajon numerik nga parapaguesi.

Parapaguesi duhet të shtrojë kërkesë për zhvendosje duke e ruajtur numrin ekzistues gjatë ndryshimit të pikës përfundimtare të rrjetit në të njëjtën rajon numerik nga parapaguesi.

Makedonski Telekom parapaguesve të shërbimeve të tij të cilët kanë kërkuar bartje gjeografike të numrit do t'i paguaj kompensim të njëfishtë për të mbuluar shpenzimet e bartjes gjeografike të numrit të përcaktuar në Çmimoren e Makedonski Telekomit.

## Kapitulli X

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE KONTRAKTUESE

#### 10.1. Të drejtat e parapaguesit

Të ketë mundësinë e shfrytëzimit të pandërprerë, efikas dhe të rregullt të shërbimeve të të gjitha shërbimeve publike të komunikimeve që mund të shfrytëzohen në pajisjet terminale që janë përkatëse me zhvillimin teknologjik të kapaciteteve të Makedonski Telekom.

Të zhvendosë lidhjen, përkatësisht shërbimin e komunikimeve në kuadër të rrjetit publik të komunikimeve në një adresë tjetër, rajonin e njëjtë ose ndonjë zonë tjetër numerike të Makedonski Telekom, përmes parashtrimit të kërkesës me shkrim dhe dëshmisë me shkrim për borxh të shlyer, me ç'rast paguan kompensim të njëhershëm sipas çmimoreve të Makedonski Telekomit.

Të kërkojë pezullimin e kontratës së tij parapaguese më së shumti një herë gjatë vitit kalendarik me kohëzgjatje prej 30 ditëve deri në tre muaj, ku gjatë kësaj kohe nuk paguhet parapagesë e rregullt mujore por kompensim i njëhershëm sipas çmimoreve të Makedonski Telekomit. Në rastet kur kontratat parapaguese janë lidhur me kohë të caktuar, domosdoshmërisht kohëzgjatja prolongohet për kohën e njëjtë sa ka zgjatuar kontrata e pezulluar.

Të kërkojë falas, në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe përmes shfrytëzimit të mjeteve të thjeshta, që Operatori të ndalojë me përpunimin e të dhënave mbi komunikacionin për shkak të marketingut të shërbimeve të komunikimeve elektronike ose për shkak të ofrimit të shërbimeve me vlerë të shtuar.

Të kërkojë falas, në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe përmes shfrytëzimit të mjeteve të thjeshta, që Operatori të ndalojë me përpunimin e të dhënave personale të parapaguesve për marketing direkt të produkteve dhe/ose shërbimeve.

Të kërkojë falas, në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë dhe përmes shfrytëzimit të mjeteve të thjeshta, ta tërheq pëlqimin për kontrollin e aftësisë së tij paguese në Byronë e Maqedonisë së Kreative. Parapaguesi ka të drejtë të prononcohet nëse do të përfshihen të dhënat e tij personale dhe cilat nga to do të përfshihen në Numërorin e vetëm telefonik dhe në shërbimin telefonik të informacioneve. Parapaguesi ka të drejtë në çdo kohë, me shkrim ose në mënyrë elektronike të kërkojë informacione shtesë në lidhje me të dhënat që Makedonski Telekom i ruan, përpunon ose i shfrytëzon për të sipas rregulloreve ligjore të kësaj fushe. Parapaguesi, po ashtu, mundet falas, në çdo kohë dhe përmes shfrytëzimit të mjeteve të thjeshta, ta tërheq ose ta kufizojë pëlqimin e dhënë paraprakisht për përpunimin e të dhënave personale dhe të dhënave për komunikacion, për shkak të marketingut të produkteve dhe shërbimeve të Makedonski Telekom.

Ta transferojë (kalojë) të drejtën e shfrytëzimit të linjës parapaguese, përkatësisht, të shërbimit të komunikimeve të personi tjetër, i cili i plotëson kushtet e nevojshme për krijimin e marrëdhënies parapaguese, përmes pëlqimit me shkrim të Makedonski Telekom dhe shlyerjes paraprake të plotë të të gjitha detyrimeve ndaj Makedonski Telekom për shërbimet e realizuara të komunikimeve. Parapaguesi i ri do të vijojë të shfrytëzojë lidhjen ekzistuese telefonike me numrin dhe kategorinë e shërbimit të përcaktuar. Të ketë qasje në shërbimin për kujdesin ndaj abonuesve për çfarëdo lloji problemesh që lidhen me shfrytëzimin e shërbimeve.

Të ketë qasje në numrin 190 të qendrës së kontaktit të Agjencisë së Komunikimeve Elektronike lidhur me ushtrimin e të drejtave të tyre.

Të kërkojë dhe të marrë informacione në lidhje me shërbimet që ofron Makedonski Telekom, si dhe çmimet dhe tarifatat për shfrytëzimin e tyre.

Të marrë informacione mbi nivelin e shfrytëzimit ose mbi tejkalimin e ofertave të caktuara të favorshme që ka shfrytëzuar sipas modelit tarifor të përzgjedhur gjatë një muaji, si dhe mbi çështjen se pas shfrytëzimit ose tejkalimit të

tyre, do të fillojë të vlejë modeli dhe mënyra tjetër (e ndryshuar) e tarifimit.

Ta anulojë, sipas kërkesës së tij, shfrytëzimin e shërbimeve të caktuara shtesë, për të cilat nuk paguhet parapagesë shtesë mujore dhe të cilat automatikisht janë në dispozicion me vet përzgjedhjen e modelit tarifor që do të shfrytëzohet. Parapaguesi ka të drejtë të parashtrijë kundërshtim (ankimim) te operatorit lidhur me ofrimin e shërbimeve, kundërshtim për vlerën me të cilën detyrohet për shërbimin e ofruar, kundërshtim për cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe kundërshtim për shkak të shkeljes së dispozitave të kontratës së nënshkruar për lidhjen dhe shfrytëzimin e rrjetit publik të komunikimeve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme në mënyrë publike. Parapaguesi e parashtron kundërshtimin me shkrim. Kundërshtimi duhet të përfshijë fakte dhe dëshmi në të cilat bazohet.

Parapaguesi mund të parashtrijë kundërshtimin në afat prej 15 ditëve nga dita e shkeljes së lartpërmendur.

**Në rast se refuzohet kundërshtimi si i pabazë, operatori detyrohet që parapaguesit t'i lëshojë vërtetim mbi kontrollin e kryer, me elemente të pasqyruara dhe të cekura saktë nga kontrolli administrativ dhe/ose teknik. Operatori është plotësisht përgjegjës për vërtetësinë e konstatimeve të dhëna në vërtetim.**

Nëse parapaguesi parashtron kundërshtim te operatorit, ndërsa më pas kërkesë për zgjidhjen e kontestit para agjencisë, sa i përket vlerës së faturës, operatori nuk mund ta kufizojë qasjen në shërbime deri kur të miratohet vendimi përfundimtar nga AKE-ja, ndërsa parapaguesi detyrohet ta paguajë vlerën e parapagesës mujore në afatin e përcaktuar. Nëse parapaguesi nuk e paguan vlerën e parapagesës mujore në afatin e përcaktuar, operatori ka të drejtë ta kufizojë qasjen në shërbime.

Nëse parapaguesi nuk është i kënaqur nga vendimi i miratuar mbi kundërshtimin, atëherë ka të drejtë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, të parashtrijë kërkesë për zgjidhjen e kontestit në agjenci.

Nëse operatori nuk vepron në lidhje me kundërshtimin në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kundërshtimit, parapaguesi ka të drejtë të parashtrijë kërkesë për zgjidhjen e kontestit në agjenci, në afat prej 35 ditëve nga parashtrimi i kundërshtimit te operatorit.

## 10.2. Të drejtat e Makedonski Telekomit

Në përputhje me programin e zhvillimit dhe planet teknike dhe sipas rregulloreve ligjore në fuqi, mund të kryejë ndryshimin e numrit parapagues së parapaguesit, përmes njoftimit paraprak të parapaguesit, të dorëzuar te parapaguesi më së voni 30 ditë para ndryshimit.

**Nga parapaguesit e tij t'i kërkojë të dhënat personale të përcaktuara me ligj.**

**T'i shfrytëzojë të dhënat personale të parapaguesve për marketing direkt të produkteve dhe/ose shërbimeve të operatorit, vetëm në bazë të pëlqimit të tyre paraprak, me detyrimin që parapaguesve t'u mundësojë falas, në çdo kohë dhe përmes shfrytëzimit të mjeteve të thjeshta ta ndalojnë shfrytëzimin e të dhënave të tyre personale.**

**T'i përpunojë të dhënat mbi komunikacionin për shkak të marketingut të shërbimeve të komunikimeve elektronike ose për shkak të ofrimit të shërbimeve me vlerë të shtuar gjatë kohëzgjatjes së kontratës së parapagesës. Me nënshkrimin e kontratës parapaguese, konsiderohet se parapaguesi ka dhënë pëlqim për përpunimin e të dhënave mbi komunikacionin, për qëllimet e lartpërmendura.**

**Të dhënat e aftësisë paguese të parapaguesit t'i shfrytëzojë për përcaktimin e mundësisë së parapaguesit për furnizimin me pajisje terminale me çmim të subvencionuar. Parapaguesi, të cilit i konstatohet paaftësia paguese, përkatësisht borxhi në bazë të raportit të marrë nga Byroja e Maqedonisë e Kredive, nuk ka të drejtë për furnizim me pajisje terminale me çmim të subvencionuar.**

Të arkëtojë kompensim për lidhjen fillestare, kompensim mujor për linjën parapaguese, si dhe kompensim për vëllimin e realizuar të komunikacionit të komunikimeve dhe për shërbimet shtesë që shfrytëzohen.

Për riaktivizimin e linjës parapaguese të shkycur për shkak të pagesës me vonesë ose mos pagesës së faturës, ta detyrojë parapaguesin, përveç borxhit të paguar, të paguajë edhe kompensim për riaktivizimin e linjës parapaguese, sipas çmimoreve.

Të vendos ndalesë për shfrytëzimin e shërbimeve shtesë dhe shërbimeve me vlerë të shtuar, të cilat Makedonski Telekom me kontratë të veçantë i siguron nga disa operatorë dhe/ose ofrues të shërbimeve, e për të cilat parapaguesi gjatë shfrytëzimit të këtyre shërbimeve ka bërë borxh që nuk e ka paguar në afatin e përcaktuar në kontratën parapaguese. Nëse teknikisht është e mundur, Makedonski Telekom ka të drejtë ta kufizojë qasjen vetëm në shërbimet për të cilat parapaguesi ka kryer shkelje, përveç se në rastet e keqpërdorimit dhe vonesës së vazhdueshme të pagesës ose mospagesës së faturave.

Të kryejë verifikimin dhe kontrollin e funksionit (rregullshmërisë) të pajisjes terminale dhe instalimeve të parapaguesit.

Për shkak të mospagesës në kohë të faturave, të realizojë shkycjen e linjave të tjera parapaguese në kontratën e njëjtë parapaguese, madje edhe nëse faturat e tjera parapaguesi i ka paguar në kohë.

Të realizojë shkycjen përfundimtare të shërbimeve në rast të keqpërdorimit ose prolongimit të pagesës.

Të realizojë arkëtimin e kërkesës së tij nga parapaguesi – pararendësi ligjor/personi juridik i sapoformuar sipas dispozitave të Ligjit të Marrëdhënieve Obligative.

Makedonski Telekom nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e komunikimeve që transferohen përmes rrjetit të tij. Makedonski Telekom mund në përbërje të modeleve tarifore, përkatësisht të pakove të abonuesve të ofrojë bonus për shërbimin publik zanor, në formë të minutave falas ose të pasqyruar në vlerën monetare apo në ndonjë mënyrë tjetër, madje edhe për komunikacionin e realizuar në kuadër të rrjetit vetanak fiks të komunikimeve, si dhe për thirrjet e

parapaguesit drejt destinacioneve ndërkombëtare dhe rrjeteve celulare të realizuara përmes Makedonski Telekomit.

### 10.3. Detyrimet e parapaguesit

Të paguajë në kohë vlerat e faturuarave për shërbimet publike të komunikimeve të shfrytëzuara në afatin e caktuar në faturë, madje edhe në rastet kur është parashtruar kundërshtim për vlerën e faturës.

Mospranimi i faturës nuk e liron parapaguesin nga detyrimi për të paguar borxhin në kohë.

**T'i shfrytëzojë shërbimet e komunikimeve vetëm për nevojat e tij dhe në përputhje me destinimin e tyre, të mos shqetësojë abonuesit të tjerë, të mos ofrojë shërbime dhe kapacitete lidhur me komunikimin, që janë lëndë e kësaj kontrate, personave të tjerë me kompensim dhe mos t'i shfrytëzojë ato për qëllime në kundërshtim me ligjin e lartpërmendur ose ligjet dhe rregullat e tjera, si dhe kushtet e përfshira me këtë kontratë.**

Parapaguesi është përgjegjës edhe për shfrytëzimin e lidhjes telefonike, kur atë e shfrytëzojnë edhe persona të tretë, të cilëve ai ua ka mundësuar këtë.

Në afat prej 15 ditëve, duhet ta njoftojë me shkrim Makedonski Telekomit për çdo ndryshim të të dhënave të nevojshme për lidhjen e kësaj kontrate, të cilat janë të domosdoshme për dërgimin e rregullt të njoftimeve dhe faturave. Çdo veprim i kundërt me këtë, do të jetë në dëm të parapaguesit, ndërsa Makedonski Telekom nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi.

Të mundësojë qasjen në pikën kyçëse të pajisjes terminale për personat teknikë të autorizuar të Makedonski Telekomit me urdhëresë të lëshuar nga shërbimi profesional i Makedonski Telekomit.

Të shfrytëzojë vetëm pajisjet terminale në përputhje me kushtet e përcaktuara në rregulloret që rregullojnë çështjet lidhur me pajisjet terminale radio telekomunikuese dhe/ose në planin për destinimin e shtrirjeve të radiofrekuencave në Republikën e Maqedonisë.

Të respektojë çdo udhëzim dhe njoftim të Makedonski Telekomit në lidhje me shfrytëzimin e shërbimeve dhe pajisjeve.

Të përmbahet nga çdo veprim që do të rrezikonte ose shkaktonte dëmim të rrjetit.

Të marrë përsipër shpenzimet e mënjanimi të defekteve të pajisjeve, instalimit dhe rrjetit, të shkaktuara për fajin e tij.

Në rast të mos pranimit të faturës mujore telefonike, të informohet në shërbimet e specializuara për marrëdhënie me abonuesit e Makedonski Telekomit dhe të kërkojë kopjen e saj.

Mos ta shfrytëzojë linjën parapaguese për telefonata shqetësuese ose telefonata të rreme.

**Pajisjet terminale, që janë pronë e Makedonski Telekomit, duhet t'i ruajë, mirëmbajë në gjendjen e duhur teknike dhe të kujdeset për to si nikoqir i mirë.**

Parapaguesi në rast se ka parashtruar kundërshtim ose njoftim për dëm, detyrohet të lejojë qasjen e personit teknik të autorizuar në hapësirat e tij gjatë orarit të punës (nga ora 8:00 deri në orën 18:00) me qëllim që të kryejë kontrollet e nevojshme dhe të verifikojë funksionalitetin e instalimeve ose pajisjeve terminale.

Parapaguesi detyrohet të lejojë që linja e tij e parapaguese të shfrytëzohet për thirrjet ndaj Ndhimës së parë, Institucionit të zjarrfikësve, Policisë, edhe në rastet e fatkeqësive natyrore.

Parapaguesi detyrohet ta paguajë parapagesën e tij mujore për periudhat kur shërbimi ishte i ndërprerë, në rastet kur ai ishte i shkyçur për shkak të pajisjeve terminale të pamiratuara dhe të papërcaktuara.

**Shërbimet e Makedonski Telekomit mund t'i shfrytëzojë vetëm për nevojat e tij dhe nuk mund t'ia transferojë shërbimin ose ndonjë pjesë të shërbimit për shfrytëzim të përkohshëm ose të përhershëm personave të tretë, pa miratim paraprak me shkrim nga Makedonski Telekomit. Qartazi ndalohet shfrytëzimi i shërbimeve të Makedonski Telekomit për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve pa kontratë të veçantë të lidhur për këtë destinim me Makedonski Telekom SHA - Shkup.**

**Parapaduesi do t'i mbajë si të fshehta numrin identifikues të parapaguesit, numrin e kontratës parapaguese dhe/ose kodin e PIN-it që i është përcaktuar nga Makedonski Telekomit, përkatësisht të dhënat e tij personale të koduara.**

Parapaguesi është përgjegjës për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e të vepruarit në mënyrë të parregullt dhe/ose keqpërdorimit ose shfrytëzimit të paautorizuar të të dhënave të tij personale të koduara, numrit identifikues të parapaguesit, numrit të kontratës parapaguese dhe/ose kodit të PIN-it, me qëllim ose për shkak të neglizhencës së tij.

### 10.4 Detyrimet e Makedonski Telekomit

Të mundësojë qasjen dhe aktivizimin e shërbimeve publike të komunikimeve në afat prej 7 (shtatë) ditëve të punës nga dita e lidhjes së kësaj kontrate.

Të sigurojë shfrytëzimin cilësor dhe të pandërprerë të shërbimeve për parapaguesin, në përputhje me ligjin, rregullat dhe rregulloret e kësaj fushe, ku janë përcaktuar standardet për cilësinë e shërbimeve publike të komunikimeve.

Të mundësojë identifikimin ose parandalimin e identifikimit të numrave që telefonojnë (thirrje hyrëse) dhe telefonohen (thirrje dalje), si dhe qasje falas në numrat e shërbimeve të thirrjeve emergjente.

Të mbajë evidencë për parapaguesit e tij, adresat e tyre dhe numrat e abonuesve.

Në kuadër të mundësive teknike, të sigurojë pacenueshmërinë dhe mbrojtjen e fshehtësisë së mesazheve që dërgohen si dhe të garantojë sigurinë, fshehtësinë dhe pacenueshmërinë e të dhënave personale dhe mbrojtjen nga cenimi i integritetit personal, që rezulton nga regjistrimi i informacioneve për parapaguesit nëpërmjet përpunimit të të dhënave, në përjashtim të rasteve të parapara me ligj.



**Për shfrytëzimin e shërbimeve, të përgatisë faturë për parapaguesin për çdo muaj dhe t'ia dorëzojë atë më së voni në ditën e 15 të muajit pasues.**

Koha maksimale gjatë së cilës Makedonski Telekom do të kryejë arkëtimin për shërbimet e realizuara të komunikimeve është 90 ditë nga dita e realizimit të shërbimit.

T'i sigurojë parapaguesit faturë të detajuar për kontrollin e vlerës së arkëtuar për shërbimet, në përputhje me ligjin.

**Në rast të shkeljes së dispozitave të kësaj kontrate, duhet ta njoftojë parapaguesin për këtë dhe t'i përcaktojë afat të arsyeshëm për plotësimin e detyrimeve të parapara me këtë kontratë.**

Në rast të ndërprerjes së përkohshme të pabazë të shërbimeve publike të komunikimeve, duhet ta lirojë parapaguesin nga pagesa e parapagesës mujore, për vlerën që është në proporcion me kohëzgjatjen e ndërprerjes. Në këtë rast, Makedonski Telekom nuk mban përgjegjësi për çfarëdolloj dëmi indirekt që mund t'i shkaktohet eventualisht parapaguesit, lidhur me fitimin e humbur, mundësitë e humbura në tregtim, reputacionin e humbur etj.

**Me kërkesë të parapaguesit, pa kompensim, duhet t'i mundësojë ndalimin e thirrjeve (telefonatave) dalëse ndaj numrave përmes të cilëve ofrohen shërbimet me vlerë të shtuar. Nëse është e mundur teknikisht, atëherë duhet t'i mundësojë ndalesë ndaj llojeve të thirrjeve dalëse si në vijim: ndaj të gjitha numrave gjeografikë të parapaguesve, ndaj të gjitha numrave jogjeografikë të parapaguesve dhe të gjitha numrave ndërkombëtare.**

**Me kërkesë të parapaguesit, t'i mundësojë, nëse është e mundur teknikisht, ndalimin e thirrjeve dalëse, nëse shpenzimet mujore të këtyre thirrjeve tejkalojnë paraprakisht vlerën e paracaktuar.**

Të ofrojë mënyrë përmes së cilës parapaguesi do të informohet lidhur me shfrytëzimin ose tejkalimin e ofertave të favorshme të caktuara që ka shfrytëzuar sipas modelit tarifor të përzgjedhur gjatë një muaji, si dhe lidhur me çështjen se pas shfrytëzimit ose tejkalimit të tyre, do të fillojë të vlejë modeli dhe mënyra tjetër e tarifimit.

Të përcaktojë çmimet për qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve publike të komunikimeve në Çmimore.

**Makedonski Telekom ka të drejtë t'u japë të dhëna dhe informacione personave me autorizime të posaçme nga organet kompetente, me aktvendim/vendim ku përcaktohet baza dhe nevoja për grumbullimin e të dhënave, personave me urdhër nga gjykata (person ekspert), inspektorëve gjatë mbikëqyrjeve inspektuese dhe organeve të tjera kompetente në përputhje me ligjin, si dhe për nevojat e shërbimeve me kompetenca të veçanta të Makedonski Telekomit.**

Makedonski Telekom, në kuadër të mundësive teknike, parapaguesit i siguron pacenueshmërinë e fshehtësisë së mesazheve, përkatësisht i ndërmerr të gjitha masat për mbrojtjen pacenueshmërisë së fshehtësisë së mesazheve të dërguara.

Makedonski Telekom nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen e njoftimeve dhe mesazheve që transferohen (dërgohen) përmes rrjetit të tij.

Makedonski Telekom detyrohet që në kohë sa më të shkurtër të mundshme ta kyç parapaguesin pas paraqitjes së dëshmisë me shkrim për shlyerjen e borxhit të maturuar.

Makedonski Telekom detyrohet që ta njoftojë parapaguesin për shkyçjen e përkohshme për shkak të mospagesës.

#### 10.5 Përgjegjësitë e Makedonski Telekomit

Makedonski Telekom nuk mban përgjegjësi për dëmet që mund të ndodhin nëse lidhja e komunikimit nuk është realizuar ose lidhja është ndërprerë gjatë kohës së komunikimit.

## Kapitulli XI

### KOHËZGJATJA DHE NDËRPRERJA E KONTRATËS, NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES JURIDIKE PARAPAGUESE

#### 11.1. Kohëzgjatja e kontratës parapaguese

Kontrata parapaguese mund të lidhet për kohë të pacaktuar dhe të caktuar me kohëzgjatje të detyrueshme të kontratës e cila përcaktohet në kërkesën ose në aneksin/shtojcën e kontratës për krijimin e marrëdhënies parapaguese sipas modelit/pakos tarifore të përzgjedhur nga parapaguesi.

#### 11.2. Ndërprerja e kontratës nga ana e parapaguesit

Parapaguesi mund të ndërpresë kontratën parapaguese me operatorin në çdo kohë pas parashtrimit paraprak të kërkesës për ndërprerjen e kërkesës parapaguese. Kërkesa me shkrim duhet të përmbajë të paktën të dhënat në vijim:

- emri ose emërimi i parapaguesit;
- numri amë për personat fizikë dhe numri tatimor dhe i regjistrimit për personat juridikë;
- adresa e linjës parapaguese;
- shërbimi i komunikimeve elektronike (modeli tarifor/pakoja/ numri parapagues dhe etj.) dhe
- data e ndërprerjes së kontratës parapaguese, nuk mund të jetë më e shkurtër se 5 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës.

Kontrata konsiderohet e ndërprerë nga dita e shënuar në kërkesën me shkrim.

Parapaguesi, edhe pas përfundimit të kontratës parapaguese, do të jetë përgjegjës për pagesën e të gjitha shpenzimeve të realizuara nga ai, të cilat eventualisht janë faturuar me vonesë ose janë faturuar, por nuk janë paguar nga parapaguesi.

Pas ndërprerjes së kontratës parapaguese, parapaguesi duhet t'i kthejë pajisjet e komunikimeve në pronësi të operatorit në gjendje të rregullt, të cilën e konstaton operatori gjatë pranimit të pajisjeve (mjeteve).

### 11.3. Ndërprerja e kontratës nga ana e Makedonski Telekomit

Makedonski Telekom mund ta ndërpresë kontratën, veçanërisht:

- për shkak të shkeljes dhe/ose mospërbushjes së detyrimeve të parapaguesit të parapara me kontratë ose me kushtet e përgjithshme.
- nëse shërbimi publik i komunikimeve shfrytëzohet ose destinohet të shfrytëzohet për qëllimin që është në kundërshtim me kushtet e kontratës.
- nëse parapaguesi e shfrytëzon linjën parapaguese dhe shërbimet përkatëse të komunikimeve për të ofruar shërbime të komunikimeve për abonuesit e tretë për kompensim të caktuar dhe pa lidhur paraprakisht kontratë përkatëse me Makedonski Telekom.
- në rast të vdekjes të parapaguesit, nëse linja nuk i kalon (transferohet) ndonjë personi tjetër në afat prej 6 muajve.
  - me vendim gjykate për fshirjen nga regjistri përkatës.
- në rast të falimentimit apo likuiditetit ose jolikuiditetit të parapaguesit, nëse e drejta e shfrytëzimit të shërbimit nuk i kalon (transferohet) ndonjë personi tjetër në afat prej 2 muajve.
- në rast të shfrytëzimit dhe keqpërdorimit të shërbimeve nga parapaguesi për qëllime në kundërshtim me ligjin, rregulloret e miratuara në bazë të tij, si dhe ligjet dhe rregulloret e tjera, të cilët janë konstatuar nga organi kompetent.
- nëse Makedonski Telekom nuk është në gjendje të ofrojë shërbime për shkak të forcës madhore për më shumë se tre muaj.

Në rast të ndërprerjes së kësaj kontrate, të gjitha detyrimet financiare të parapaguesit ndaj Makedonski Telekomit do të ndërpriten menjëherë.

Në rast të ndërprerjes së kësaj kontrate për shkak pagesës së vonuar, parapaguesi nuk mund të lidhë kontratë parapaguese para se t'i shlyejë plotësisht detyrimet financiare ndaj Makedonski Telekomit.

Nëse për parapaguesin është iniciuar procedurë e falimentimit ose procedurë e likuiditetit, administruesi i falimentimit ose likuiduesi detyrohet me shkrim ta njoftojë Makedonski Telekomin për këtë procedurë në afat prej 30 ditëve nga dita kur është iniciuar procedura. Nëse administruesi i falimentimit ose likuiduesi në njoftimin me shkrim kërkon ndryshimin e emrit (titullit) të parapaguesit dhe transferimin e kontratës parapaguese, Makedonski Telekom do ta transferojë kontratën parapaguese dhe do të kryejë ndryshimet e nevojshme në titullin e parapaguesit.

## Kapitulli XII

### KUNDËRSHTIME

#### 12.1. Parashtrimi i kundërshtimeve

Parapaguesi ka të drejtë të parashtojë kundërshtim (ankimim) në Makedonski Telekom lidhur me ofrimin e shërbimeve, kundërshtim për vlerën me të cilën detyrohet për shërbimin e ofruar, kundërshtim për cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe kundërshtim për shkak të shkeljes së dispozitave të kontratës së nënshkruar për lidhjen dhe shfrytëzimin e rrjetit publik të komunikimeve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Kundërshtimi parashtrohet me shkrim. Kundërshtimi duhet të përfshijë fakte dhe dëshmi në të cilat bazohet.

Kundërshtimi parashtrohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shkeljes së lartpërmendur. Kundërshtimi i parashtruar pas përfundimit të afatit konsiderohet si i vonuar.

Në rast të parashtrimit të kundërshtimit nga ana e parapaguesit, Makedonski Telekom duhet të kontrollojë vlerën për të cilën detyrohet parapaguesi ose cilësinë e shërbimit të ofruar, më pas në bazë të kontrollit administrativ dhe/ose teknik të kryer, ta përcaktojë vlerën ose cilësinë e shërbimit.

Nëse parapaguesi parashtron kundërshtim te operatori, më pas edhe kërkesë për zgjidhjen e kontestit para agjencisë, lidhur me vlerën e faturës, Makedonski Telekom nuk mund ta kufizojë qasjen në shërbimet deri kur të miratohet vendimi përfundimtar, ndërsa parapaguesi detyrohet ta paguajë vlerën e parapagesës mujore në afatin e përcaktuar.

Makedonski Telekom duhet të sjellë vendim për kundërshtimin në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij dhe lidhur me të, ta njoftojë me shkrim parapaguesin.

Nëse parapaguesi nuk është i kënaqur me vendimin e sjellë lidhur me kundërshtimin, ka të drejtë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të tij, të parashtojë kërkesë për zgjidhjen e kontestit në agjenci.

Nëse Makedonski Telekom nuk vepron në lidhje me kundërshtimin në afatin e përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni, parapaguesi ka të drejtë të parashtojë kërkesë për zgjidhjen e kontestit në agjenci, në afat prej 35 ditëve nga dita e parashtrimit të kundërshtimit në Makedonski Telekom.

Nëse konstatohet se Makedonski Telekom ka shkelur dispozitat e kontratës së lidhur ose në mënyrë të paarsyeshme ka ndërprerë ofrimin e shërbimit për parapaguesin që ka parashtruar kundërshtim, për shkak të shkeljes së dispozitave të kontratës së lidhur ose kundërshtimit për ndërprerje të paarsyeshme të shërbimit, parapaguesi ka të drejtë ta ndërpresë kontratën pa kompensim, si dhe të drejtë t'i kthejë të gjitha mjetet monetare të arkëtuara në mënyrë të paarsyeshme.

Nëse parapaguesi parashtron kundërshtim në Makedonski Telekom në lidhje me vlerën e faturës ose cilësinë e shërbimit të ofruar me vlerë të shtuar, atëherë duhet të kryhet kontrolli i kundërshtimit dhe të dërgohet te Ofruesi i shërbimeve me vlerën përkatëse në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të kundërshtimit nga parapaguesi. Makedonski Telekom, duhet ofruesit të shërbimit me vlerë të shtuar, t'ia japë emrin, mbiemrin dhe adresën e parapaguesit, si dhe të dhënat e verifikuara për faturën kontestuese ose cilësinë e shërbimit me vlerë të shtuar.

Ofruesi i shërbimit me vlerë të shtuar që ofron shërbimin me vlerë të shtuar duhet t'i përgjigjet kundërshtimit në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e pranimit të tij.

Makedonski Telekom e njofton me shkrim parapaguesin mbi vendimin ndaj kundërshtimit të parashtruar.

Dispozitat që lidhen me qasjen në shërbime ose ofrimin e tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për kundërshtim ndaj vlerës së faturës telefonike, zbatohen në mënyrë përkatëse sipas raportit ndërmjet pagesës së faturës dhe me përmbajtjes së njoftimit, pas kundërshtimit të parashtruar nga parapaguesi në lidhje me vlerën e faturës ose cilësinë e shërbimit të ofruar me vlerë të shtuar.

## Kapitulli XIII

### MBLEDHJA, PËRPUNIMI, RUAJTJA DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE TË ABONUESVE

Sipas Ligjit për Komunikime Elektronike (LKE), Makedonski Telekom SHA-Shkup ka për obligim të mbajë shënime të sakta për abonuesit e vet dhe të drejtën për të mbledhur, përpunuar dhe ruajtur të dhënat e tyre personale për qëllime të kontraktimit dhe përmbushjes së kontratave parapaguese, duke përdorur dhe tarifuar shërbimet, dhënien e informacionit tek autoritetet kompetente shtetërore në procedurën e përcaktuar me ligj si dhe për qëllime të tjera sipas ligjit. Operatori ka të drejtë t'i përpunojë, shkëmbejë dhe komunikojë të dhënat për abonuesit dhe për komunikacionin e tyre të arritur të komunikimit pa pëlqim shtesë për qëllime të përmbushjes së qëllimeve të përmendura më lart dhe për qëllime të tjera të lejuara në përputhje me ligjet në fuqi.

Në bazë të një interesi të përcaktuar legjitim ose me pëlqimin e marrë të abonuesve, Operatori mund t'i përpunojë të dhënat e tyre personale për qëllime të tjera. Pëlqimi i dhënë për përpunimin e të dhënave personale nga abonuesit është i vlefshëm deri në tërheqjen e tij. Abonuesi ka të drejtë ta japë ose ta tërheqë pëlqimin e dhënë në çdo kohë përmes një prej kanaleve të specifikuara në Politikën e Privatësisë të publikuar në faqen e internetit të Operatorit.

Abonuesi është përgjegjës për saktësinë e të dhënave personale të dhëna dhe besueshmërinë e dokumenteve që i dorëzohen Operatorit gjatë paraqitjes së Kërkesës për kontraktimin e kontratës së abonimit. Gjatë ndryshimit të ndonjë të dhëne të Abonuesit gjatë vlefshmërisë së kontratës abonuese, Abonuesi është i detyruar të kërkojë nga Operatori ndryshimin e tyre dhe të paraqesë dëshminë e duhur për të dhënat e ndryshuara.

Makedonski Telekom SHA-Shkup do t'i ndërmarrë masat e duhura teknike dhe organizative për të siguruar konfidencialitetin e komunikimeve dhe sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale të Abonuesit në përputhje me dispozitat në fuqi të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe LKE.

Operatori mund të angazhojë edhe palë të treta për ofrimin e shërbimeve të komunikimit si përpunues dhe nënpërpunues dhe të kontraktojë marrëveshje të përshtatshme me ta për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me ligjin.

Pas shkëputjes së kontratës së abonimit, operatori është i detyruar t'i ruajë të dhënat e abonuesit dhe trafikun e tij të komunikimit për një periudhë të përcaktuar me ligj, pas së cilës i fshin ose i anonimizon ato."

## Kapitulli XIV

### DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

#### 14.1. Ndryshimet dhe Plotësimet e Kushteve të përgjithshme

Makedonski Telekom, me vendim vetanak, sidomos nëse imponohet nga kushtet e tregut ose ndryshimet në rregullativën ligjore, mund t'i ndryshojë ose plotësojë Kushtet e përgjithshme. Megjithatë, Makedonski Telekom i njofton në kohë parapaguesit për ndryshimet në Kushtet e përgjithshme.

#### 14.2. Zbatimi i Kushteve të përgjithshme

Këto Kushte të përgjithshme të Makedonski Telekomit do të zbatohen për parapaguesit nga dita e hyrjes së tyre në fuqi.

#### 14.3. Forca madhore

Shfrytëzimi i shërbimeve të ofruara nga Makedonski Telekom mund të ndërpritet për shkak të forcës madhore. Me forcë madhore, nënkuptohet ngjarje që nuk varet nga vullneti i palëve kontraktuese, paraqitja e së cilës nuk mund të parandalohet ose parashikohet dhe për shkak të së cilës vështirohet ose pamundësohet plotësimi i detyrimeve të kontratës, duke përfshirë, por pa u përkufizuar në: ngjarjet natyrore, ngjarjet sociale (grevë, trazira, luftë), aktet e pushtetit publik, çrregullimet në funksionimin e sistemit etj.

Makedonski Telekom nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj parapaguesit për shkak të ndërprerjes së shërbimeve të tij, të shkaktuar nga ndonjë ngjarje e forcës madhore.

#### 14.4. Zgjidhja e kontesteve

Kontestet që paraqiten ndërmjet palëve kontraktuese do të zgjidhen me marrëveshje, në të kundërtën do të vendosë Gjykata Themelore Civile Shkup. Këto Kushte të përgjithshme, duke përfshirë edhe kontratën, do të interpretohen në

përputhje me rregullat dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

#### 14.5. Hyrja në fuqi

Kushtet e përgjithshme hyjnë në fuqi në ditën e miratimit të tyre, ndërsa do të zbatohen nga dita e publikimit të tyre në faqen e internetit të Makedonski Telekom. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtyre Kushteve të përgjithshme, nuk janë të vlefshme më të gjitha kushtet e përgjithshme të publikuara paraprakisht.

Publikuar më datë 18.10.2024.